



**ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΤΙΡΑΝΩΝ  
ΣΧΟΛΗ ΙΣΤΟΡΙΑΣ ΚΑΙ ΦΙΛΟΛΟΓΙΑΣ  
ΤΜΗΜΑ ΑΛΒΑΝΙΚΗΣ ΓΛΩΣΣΑΣ**

Μεταπτυχιακή Εργασία

**«ΛΕΞΙΛΟΓΙΚΕΣ, ΣΗΜΑΣΙΟΛΟΓΙΚΕΣ ΚΑΙ  
ΛΕΞΙΚΟΓΡΑΦΙΚΕΣ ΑΞΙΕΣ ΣΤΟ «ΝΕΟ ΛΕΞΙΚΟ» ΤΟΥ  
ΠΑΝΟ ΤΑΣΕ»**

**Επιβλέπων Καθηγητής**

**ΝΤΟΝΙΚΑ ΜΠΟΜΠΟΛΗ**

**Αναπλ. Καθηγητής ΒΑΛΤΕΡ ΜΕΜΙΣΑ**

**ΤΙΡΑΝΑ, 2006**

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. Hyrje
2. Vështrim i përgjithshëm
  - a. - Koha kur botohet “Fjalorthi i ri”
  - b. - Pano Tase dhe ndihmesa e tij në lëmin e kulturës kombëtare
  - c. - Vlerësime për “Fjalorthin e ri”
3. Rreth pasurisë leksikore të “Fjalorthit të ri”
  - a. Leksiku i përgjithshëm
  - b. Leksiku terminologjik
  - c. Fushat kryesore konceptore e leksikore
    - Emërtime lulesh
    - Emërtime bimësh
    - Emërtime pemësh
    - Emërtime kafshësh
    - Emërtime shpendësh
    - Emërtime insektesh
    - Emërtime për zejesh e për vegla pune
    - Eufemizma
    - Psthirra
4. Rreth pasurisë frazeologjike të “Fjalorthit të ri”
  - a. Pasuria frazeologjike
    - modelimi semantik
    - modelimi strukturor
    - modelimi leksiko -gramatikor
  - b. Pasuria e shprehjeve popullore
    - Përshëndetje
    - Urime
    - Ngushëllime
    - Mallkime
    - Betime
  - c. Veçori të ndërtimit sintagmatik të shprehjeve popullore
5. Rreth pasurisë semantike të “Fjalorthit të ri”
  - a. Veçori onomasiologjike
  - b. Polisemia
  - c. Sinonimia
  - d. Antonimia
  - e. Homonimia
6. Veçori morfo-strukturore e fjalëformuese të leksikut të Fjalorthit
  - a. Emërtime të thjeshta
    - Fjalë të parme
    - Fjalë jo të parme
      - me prejardhje
      - me përbërje

- me përngjitje
- me nyjëzim
- me konversion

b. Emërtime të pathjeshta

7. Rreth vlerave leksikografike të “Fjalorthit të ri”

- a. Strukturat kuptimore dhe shpjegimet e kuptimeve
- b. Thëniet dhe vendi i tyre në “Fjalorthin e ri”

8. Rreth marrëdhënieve të pasurisë leksikore e semantike të “Fjalorthit të ri” me leksikun e gjuhës letrare

- a. Fjalorët shpjegues të shqipes dhe “Fjalorthi i ri”
- b. Fjalori i madh i shqipes dhe “Fjalorthi i ri”

9. Veçori fonetike e morfologjike të leksikut të “Fjalorthit të ri”

10. Përfundime

11. Literatura e konsultuar

## HJRJE

*Këto vitet e fundit, sidomos këtë fillim shekulli, vërejmë me kënaqësi se edhe në Shqipëri (ashtu si më herët në Kosovë) po ribotohen shumë vepra gjuhësore (dhe jo vetëm gjuhësore) të traditës. Po përmendim ribotimin e Fjalorit latinisht – shqip të Frang Bardhit, të Çetës së Profetëve të Pjetër Bogdanit, të Fjalorit të ri të Nikolla Gazullit, të Fjalorthit të ri të Pano Tases, të Fjalorit të gjuhës shqipe të vitit 1954, të Teksteve të vjetra të Rexhep Ismajlit, të “Në gjuhë” dhe për gjuhë” po e Rexhep Ismajlit e shumë vepra të tjera që tashmë kanë zënë vend në fondin e artë të kulturë sonë kombëtare. Këto vepra jo vetëm janë mirëpritur në kohën kur janë botuar, por edhe më vonë në rrjedhë të dhjetëvjeçarëve atë shekujve. Ka asish që për një rëndësi a për tjetrën nuk është vlerësuar a nuk është analizuar si e sa duhet. Një fat të tillë ka pasur edhe Fjalorthi i ri i Pano Tases. Siç do të shohim në faqet e këtij punimi që po paraqesim si mikrotezë, botimi i këtij Fjalorthi dhe i Fjalorit të N. Gazullit në vitin 1941 në kolanën “Visare të kombit” përbëjnë ngjarje në historinë e gjuhësisë shqiptare. Këta fjalorë nuk ishin botime që mbeten thjesht në fushën e leksikografisë a të leksikografisë dialektore e krahinore, si kanë dashur t’i pozicionojnë për rreth 50 vjet në literaturën gjuhësore. Por shumë më tepër. Vetë botimi nën këtë sigël (“Visare të kombit”) është shumë kuptimplotë dhe shumë domethënëse.*

*Kundrimi i plotë apo nga këndvështrime e prerje të ndryshme, analiza të herëpashershme dhe shteruese të lëndës leksikore, semantike frazeologjike etj., që ata përmbajnë, krijojnë shtysa për sipërmarrje si kjo jona ose për sipërmarrje më të thella e më të plota si ato në nivel tezash (doktorature).*

*Së bashku me udhëheqësin shkencor menduam se, duke shqyrtuar lëndën që përmban **Fjalorthi i ri** Pano Tases, duke parë e duke vlerësuar ndihmesën e tij në përdhësimin e leksikografisë shqipe njëgjuhëshe, mund të paraqesim më hollësisht disa nga arritjet e veprës, ashtu si edhe mangësitë që kanë kushtëzimet e kohës, të traditës leksikografike e leksikologjike dhe së fundi të mungesës së profesionalizmit të hartuesit.*

*Së pari, bëme shestim të temës dhe vazhduam punën, duke e përqendruar vëmendjen në tri dukuri themelore.*

*a. Morëm në dorë Fjalorthin dhe u njohëm imtësisht me të, duke e përqasur me arritjet më të mira leksikografike njëgjuhëshe të shqipes.*

*b. Së dyti, punuam me një literaturë të larmishme shkencore që do të na udhëhiqte gjatë gjithë punës sonë dhe do të lehtësonte e do të mundësonte interpretimin e vlerësimin e lëndës që mbart Fjalorthi i ri.*

*c. Së treti, punuam drejtpërdrejt në çështjet e mëposhtme:*

*1. Vështrim i përgjithshëm, duke u ndalur në kohën kur botohet “Fjalorthi i ri”, në ndihmesën e Pano Tase në lëmin e kulturës kombëtare dhe në disa vlerësime për veprën që nga çasti i botimit e deri më sot.*

*2. Një nga çështjet që është parë hollësisht dhe me përkushtim është Pasuria leksikore, semantike e frazeologjike e “Fjalorthit i ri”. Shpesh thuhet se vepra përmban rreth 2000 njësi leksikore, por gjatë punës na ka dalë se kemi në duar dyfishin e këtij pohimi. Këtu kemi bërë analiza, grupime e rigrupime sipas koncepteve a praktikave bashkëkohore dhe për çdo dukuri jo vetëm kemi pohuar prirjet dhe arritjet, por kemi mbajtur dhe qëndrimin tonë.*

*3. Na ka bërë përshtypje edhe pasuria e madhe Shprehjeve popullore (përshtypjet, urimet, mallkimet, betimet etj.) të zonës së Përmetit dhe të pasqyruar në Fjalorth. Ndaj jemi ndalur jo pak edhe në këtë grup paradigmatic, duke bërë edhe analiza etnolinguistike.*

*4. Nuk kemi anashkaluar edhe çështje të tilla që janë me interes për morfologjinë e semantikën morfologjike si, Veçoritë morfo-strukturore e fjalëformuese të leksikut të Fjalorthit, duke analizuar emërtimet e thjeshta (fjalët e parme e jo të parme) si dhe emërtimet e pathjeshta (që zënë një vend jo të vogël në vepër).*

*5. Nuk mund të linim pa shqyrtuar edhe probleme të tilla si Vlerat leksikografike të “Fjalorthit të ri” apo marrëdhëniet e pasurisë leksikore e semantike të “Fjalorthit të ri” me leksikun e gjuhës letrare të njësuar.*

*Në punim zënë vend edhe një radhë përfundimesh e detyrash të mëtejshme si dhe literatura shkencore e konsultuar.*

*Mendojmë se po paraqesim për mbrojtje një punim modest, por që shpërfaq, edhe si përshkrim shkencor, vlerat e shumëfishta të “Fjalorthit të ri” të Pano Tases, duke krijuar një hapësirë të re për t’iu rikthyer edhe njëherë veprave të përmasave të tilla e me pasuri të admirueshme.*

*Së fundi e ndiej si detyrim të falënderoj udhëheqësin shkencor, prof. as. dr. Valter MEMISHA, ndihma e të cilit nuk më mungoi asnjë çast dhe më ka lehtësuar dukshëm përgatitjen e punimit. Gjithashtu, falënderoj pedagogët e Departamentit të gjuhës shqipe në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, si edhe pedagogët e Universitetit “E. Çabej” të Gjirokastrës, që nuk janë kursyer për të më dhënë dorë në mbarëvajtjen e punës, aq të bukur e njëherazi, aq të vështirë e me përgjegjësi.*

## KREU II

### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

#### A. KOHA KUR BOTOHET “FJALORTHI I RI”

Jemi në mesin e shek. XX dhe pikërisht në fillim të viteve ‘40. Shteti shqiptar po mbushte dalëngadalë 30 vjet jetë. Gjatë kësaj kohe, krahas arritjeve në fusha të ndryshme, dalloheshin edhe përpjekjet herë të planifikuara, herë spontane për emancipimin kulturor e sidomos për zhdukjen e analfabetizmit e për arsimin e popullsisë që ishte gati mbi 80 % analfabete. Gjithashtu, duke ndjekur traditën më të mirë të Rilindjes sonë Kombëtare, u bënë përpjekje për të ruajtur e për të pasuruar trashëgimin e gjithanshme e për të nxjerrë në pah ato vlera që e bënin popullin shqiptar një nga popujt më të vjetër të Evropës. Kishte mbi dhjetë vjet që nën kolanën “Visare të kombit” që po botoheshin Eposi i Kreshnikëve, Epika Historike etj.

Ndër të tjera gjatë këtyre viteve u bënë përpjekje të drejtpërdrejta dhe të planifikuara për unifikimin e gjuhës letrare kombëtare. Administrata a arsimin në shtetin shqiptar, edhe pse nën pushtimin fashist, kishte përcaktuar si strategji që t’u ofronte përdoruesve të shqipes sa më tepër materiale gjuhësore apo letrare nga dy kryedialektet, duke synuar me kohë shkrirjen e tyre të butë e sa më objektive në shtratin e gjerë të shqipes së përbashkët.

Pano Tase e kishte ende në punim e sipër dorëshkrimin e vet dhe ndonëse nuk e kishte përfunduar ende, kish përgatitur si sprovë për vlerësim Fjalorthin e vet me afro 1600 lema. Intelektualit Karl Gurakuqi, që atëherë drejtonte Inspektoriatin e Lartë në Ministrinë e Arsimit, duket se i pëlqeu shumë ky punim, përveçse i erdhi në kohën e volitshme, pikërisht kur po përgatitej për shtyp Fjalori i Gazullit. Ndaj edhe Ministria e Arsimit vendosi të botojë dorëshkrimin e Tases aq sa qe, pa pritur që mbledhësi ta quante sipas tij

të përfunduar gjurmimin dhe skedimin e fjalëve dhe shprehjeve të rralla të toskërishtes.

“Fjalorthi i ri” i Pano Tases, me nëntitullin “Fjalë të rralla të përdorura në Jug të Shqipnis”, u botua në vitin 1941 si vëllim XII i serisë “Visaret e Kombit”, në një kohën kur botohet edhe Fjalori i N. Gazullit (“*Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnisë*”). Këto dy botime me prurjet që mbartin, janë me vlera të veçanta për gjuhën shqipe.

Studiuesja Hëna Pasho thekson se “me këta dy fjalorë, pavarësisht se janë fjalorë krahinorë, mund të thuhet se nis rrugën e saj leksikografia njëgjuhëshe, hidhen hapat e parë për fjalorët shpjegues të shqipes”<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> H. Pasho, *Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri” të Pano Tases*, SF, 3-4, 2001, f. 121



## B. PANO TASE DHE NDIHMESA E TIJ NË LËMIN E KULTURËS KOMBËTARE

Pano Tase zë një vend të veçantë në trashëgiminë gjuhësore e kulturore të kombit shqiptar. Por kjo për shumë vjet nuk ka qenë e vlerësuar, duke u anashkaluar shpesh me paramendim pushtetarësh. Vetëm kohët e fundit, madje në këtë fillim mijëvjeçari, po bëhet një punë e lavdërueshme dhe tërësia e ndihmesës së këtij personaliteti po fillon të ndriçohet. Vonesa nuk është e justifikuar. Ndaj edhe ne me punimin tonë, po përpiqemi të fusim një fashë dritë në dhomën që ka qenë kaq vjet e errësuar.

Studiuesi i njohur Mark Tirta në parathënien që i bën përmbledhjes folklorike “Ç’u këput një yll...”, ku renditen disa këngë popullore dashurie të mbledhura nga hartuesi i këtij *Fjalori*, jep dëshminë mbresëlënëse:

*“Pano Tase na ka lënë trashëgimi një material të madh arkivor, të ruajtur në arkiva të ndryshme të instituteve albanologjike. Në arkivin e Institutit të Historisë ka dy dorëshkrime, me ngjarje e përshtypje për historinë e fillimit të shek. XX, me titujt:*

- *“Kujtimet e mia, 1910-1918”, 166 f.*
- *“Kujtimet e mia”, 222 f.*

*Në arkivin e etnologjisë gjenden këto materiale në dorëshkrim:*

- *“Material etnografik për Përmetin. Zakone për dasmën, vdekjen, etj.” (1959), 39 f.*
- *“Lëshica – 1920” (1963), 56 f.*
- *“Zakone nga djepi në varr” (1964), 84 f.*
- *“Legjendë matiane” (1968), 172 f.*
- *“Kanune dhe zakone nga krahina e Përmetit” (1972), 10 f.*
- *“Fshati dhe familja në Lëshicë” (1972), 106 f.*
- *“Mjekësia popullore”*
- *“Beja më e rëndë – gruaja” (1973), 45 f.*
- *“Material etnografik nga Lëshica”*

- “Material leksiko-frazeologjik nga rrethi i Përmetit”
- “Mbi frazeologjinë dhe nëmat”
- “Paragjykimet” (1973), 177 f.
- “Korrja dhe shirja e drithërave në Lëshicë” (1973), 26 f.
- “Rite e besime për botën e gjithësinë” (1974), 168 f.
- “Ushqim e pije në fshatrat e rrethit të Përmetit” (1974), 134 f.
- “Blegtoria në Lëshicë” (1975), 82 f.
- “Material ndihmës për etnografinë” (1976), 65f.

*Për arkivin e folklorit ka mbledhur materiale në vitet 1959-1964. Ka të depozituara aty gjithsej 13 defterë me këtë tematikë: 247 këngë me 3816 vargje; 1018 proverba; 21 gjëgjëza; 76 përralla; zakone lindjeje, martese e vdekjeje; 54 anekdota; dy legjenda. Në arkivin e gjuhësisë ka disa mijëra njësi fjalësh të rralla, frazeologji, toponime etj., që kanë vlerë të madhe në studimet gjuhësore”<sup>2</sup>.*

Kurse gjuhëtarja L. Shamku për këtë pasuri të vyer shprehet: “Vërtet mbresëlënëse! Është puna e një njeriu që nuk u përthith kurrë nga institucionet akademike shqiptare. Është puna e një njeriu që dashuroi gjuhën dhe vendin. E një njeriu, raca e të cilit sot në Shqipëri është në zhdukje (në mos është zhdukur krejt). Ndjesia e mirë që krijohet duke u njohur me këtë inventar të paçmuar vjen e shoqërohet vetiu nga keqardhja që gjithë kjo pasuri ende nuk u është dhënë atyre që u duhet më fort: shqiptarëve. Gjithë kjo gurrë e rrallë landore vijon sot e gjithë ditën të mbetet “robinjë” në skedarët dhe arkivat e institucioneve”<sup>3</sup>.

Duhet të parashtrojmë në këto çaste që *Fjalorthi i ri* është në proces botimi, i plotësuar dhe me një vëllim shumë më të madh njësisish se ai i botuar në vitin 1941. Ne nuk patëm mundësinë dhe nderin që të kishim në dorë dhe të

---

<sup>2</sup> M. Tirta, “Ç’u këput një yll... – këngë dashurie mbledhur nga Pano Tase”, Tiranë, 2001, f. III-IV

<sup>3</sup> L. Shamku, Fjalori që këndon, Shekulli, 12 prill 2006

punonim mbi të me (ri)botimin e tij të fundit. Ne jemi mbështetur në analizat tona në *Fjalorthin e ri* të vitit 1941.

Ledia Shamku në *Parathënien e (ri)botimit* pohon se “Botimi integral i *Fjalorit*, përveç risive që sjell në fjalësin e tij, i cili siç u tha në fillim është trefishi i *Fjalorthit të Ri*, ofron edhe një visar shumë të çmuar etnolinguistik: në të renditen, të ndara qartë e pastër nga hartuesi i tij, urime të ndryshme, si urime për dolli, urime për lindje, ngushëllime, mallkime, pendime mbas mallkimit, fjalë fyese e sharje për cene trupore, përkëdhelira, kanosje, gjëgjëza, njësi frazeologjike dhe proverba (në dy treguesit e fundit përmbliidhen vërtet një sasi e madhe njësisht). Ky visar që ofron Pano Tase është vërtet i vyer për albanologë, etnologë e historianë, E gjithë kjo lëndë, përveç etnologjisë apo folkloristikës, i shërben gjithashtu edhe gjuhësisë për të qëmtuar në të arketipin e modelit sintaksor të toskërishtes. Duke qenë se standardi i sotëm ende mbështetet mbi sistemin gramatikor toskë, një qëmtim i tillë diakronik mund të shërbejë për të rindërtuar shndërrimet e sintaksës së shqipes, gjithë në përputhje me shndërrimet mendësore të shoqërisë shqiptare, aq më tepër në këto pesëmbëdhjetë vjet si vite përcaktuese, të cilat janë karakterizuar nga braktisja masive e zonave rurale”<sup>4</sup>.

---

<sup>4</sup> L. Shamku, *Fjalori që këndon, Parathënie e Fjalorthit të ri*, në proces botimi, Tiranë, 2006

### C. VLERËSIMET PËR “FJALORTHIN E RI”

Siç kemi pohuar disa herë, “Fjalorthi i ri” doli nga botimi në vitin 1941. Bashkëkohësit e mirëpritën atë, madje vlerësimet pozitive qenë të mëdha. U shkruan artikuj me shumë dashamirësi e fjalë inkurajuese që informonin ardhjen e tij, por edhe që mbështetën gjerësisht autorin në sipërmarrjen e guximshme. Ndër të tjera ata u ndalën në punën e P. Tases për ta mbledhur, për ta trajtuar, për ta përpunuar e për ta përdorur gjuhën pastë e thjesht, pa e përzier me fjalë të huaja dhe pa e rënduar me to<sup>5</sup>.

Ne do të japim këtu disa nga mendimet më vlerësuese e më të thukëta për “Fjalorthin e ri”. Prof. Aleksandër Xhuvani, një nga njohësit më të mirë të shqipes dhe të pasurisë leksikore të saj do të shkruante për këtë veprë: “Ndër vepra të tjera ... duel në dritë këto ditë nga shtypshkronja “Luarasi” edhe një Fjalorth i ri, që përfshin fjalë e të foluna të Përmetit e që nuk gjinden ndër fjalorë të tjerë, si të Kristoforidhit e të “Bashkimit”, ase, në qoftë se gjinden disa, në këtë Fjaluer janë zhvillueme kuptime e shembëlla të tjera. Ahuktori i Fjalorthit asht Pano Taseja... Fjalorthi... asht hartue në të folunit e Jugut të Shqipnisë dhe përmbledh fjalë e të folunatë e krahinës së Përmetit. Asht punue me mjeshtëri dhe formon një ndihmesë të madhe për studimin e gjuhës shqipe. Për t’u vu re asht se Fjalorthi ka një pasuni të madhe shembëllash, frazash e sinonimesh të gjuhës dhe ata që dëshirojnë me shkruë një gjuhë shqipe pa fjalë të hueja, kanë për të gjetur në këtë Fjalor një mjet e një ndihmesë të madhe për qëllimin e tyre. Albanologëve dhe linguistëve ky Fjalorth do t’u japi shkak me studjue e me rrmue fjalët e ndryshme në pikëpamje semasiologjike dhe etimologjike. Me botimin e këtij Fjalorthi, që ka nja dy mijë fjalë, ka dalë në shesh një material tjetër i gjuhës sonë që do t’i hyjë në punë çdo shkrimtari, që ka dëshirë me shkruë një gjuhë të pastër shqipe”<sup>6</sup>.

---

<sup>5</sup> Shih më gjerë H. Pasho, *Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri”* të P.ano Tases, SF, 3-4, Tiranë, 2001, f. 121

<sup>6</sup> A. Xhuvani, *Një Fjalorth i ri*, në *Vepra*, 2, Tiranë, 1990, f. 86 – 87

Viti 1941 është viti i botimit të dy fjalorëve, i *Fjalorit të ri* të N. Gazullit dhe *Fjalorthit të ri* të P. Tases. Ata u krijuan ngjarje ndaj dhe shpesh janë vështruar pandashëm, mbase për të treguar se pasuria e tyre, edhe pse vjen nga dy treva larg njëra tjetrës, është pjesë e pasurisë së gjuhës shqipe dhe e gjithë kulturës kombëtare. Skënder Pirro (S. Spasse) shkruan për ta: “ja dy thesare të vërteta të gjuhës shqipe”<sup>7</sup>.

Karl Gurakuqi e çon lexuesin e mësuesin, nxënësin e nëpunësin e viteve 40 të shekullit të kaluar, e çon çdo shqiptar te këta fjalorë dhe u drejtohet: “merr njëherë në dorë e shfletoje, fjala vjen, Fjalorthin e fjalëve të rralla të Gazullit apo të Tases... Ke për të gjetë aty fraza nga goja e popullit me qindra e mijra, të bukura e të plota, të hijshme e të kumbueshme, qi të lanë me gojë hapët”<sup>8</sup>.

Edhe prof. Jani Thomai ka shkruar për “Fjalorthin e ri” duke e parë në së bashku me Fjalorin e N. Gazullit. Por ai është ndalur shumë shkurt, vetëm sa e përmend dhe nuk dallon a nuk specifikon ndonjë veçanti të veprës. Ai shkruan se “në periudhën e parë (nënkupto periudhën para viteve ’40 të shekullit XX) u botuan edhe disa fjalorë e fjalorthë krahinorë, me 2000 – 5000 fjalë, nganjëherë si shtojcë e përmbledhjeve folklorike. Po përmendim dy fjalorë krahinorë, me të cilët fillon historia e këtij tipi në leksikografinë shqipe: a) *Fjalori i ri* i Nikollë Gazullit (1941), me rreth 5000 fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqipërisë. Në krye të fjalorit janë vënë edhe disa parashtesa e prapashtesa kryesore të shqipes. b) *Fjalorthi i ri* i Pano Tases (1941), me rreth 2000 fjalë, kryesisht të krahinës së Përmetit, edhe me disa shprehje, urime, mallkime etj., që lidhen me këto fjalë”<sup>9</sup>.

Për shumë vjet me radhë, për gati 5 dhjetëvjeçarë, “Fjalorthi i ri”, ashtu si edhe “Fjalori” i N. Gazullit vetëm sa janë përmendur aty-këtu. Mund të themi se vetëm sa u prekur është titulli. Në një punim të mirëfilltë monografik, si “*Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*” të prof. J. Thomai, që, siç

---

<sup>7</sup> S. Pirro (S. Spasse), Shkëndija, 2, 1942, f. 40

<sup>8</sup> K. Gurakuqi, Shkëndija, 11 - 12, 1942, f. 363 - 364

<sup>9</sup> J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 1999, f. 278

thamë më lart, e pranon se fjalori i Tases është krahinor, nuk kemi asnjë analizë, qoftë edhe të sipërfaqshme, për pasurinë leksikore – semantike dhe frazeologjike të tij<sup>10</sup>. Aty kemi kundërime shkencore të hollësishme, ndër të tjera të dy fjalorëve të tjerë, të *Fjalorthit të fjalëve të rralla* të A. Zymberit, botuar në Tiranë, 1979 dhe të fjalorit *Fjalë popullore nga Myzeqeja* të J. Nushit, botuar në Tiranë në 1991. I mëshuam këtij fakti se vetë profesori, si një nga studiuesit më të mirë të leksikut dhe frazeologjisë së gjuhës shqipe, pranon te Leksikologjia e gjuhës shqipe se me fjalorin e N. Gazullit dhe atë të P. Tases fillon historia e fjalorëve krahinorë në leksikografinë shqipe<sup>11</sup>.

Studiuesja H. Pasho në një punim shumëfaqësh materialin gjuhësor të përfshirë në Fjalorth e shqyrton në këndvështrime të ndryshme për të nxjerrë në pah vlerat e tij: pasurinë leksikore e frazeologjike, veçoritë e këtij leksiku dhe veçoritë e përdorimit të mjeteve fjalëformuese. Ajo në mbyllje të tij nxjerr disa përfundime që janë edhe vlerësime për vetë veprën: “a. Tërësia e materialit gjuhësor të pasqyruar në këtë fjalor është vërtet një pasuri, jo vetëm nga ana sasiore, por edhe cilësore; vërtetësia dhe saktësia e leksikut dhe e frazeologjisë ka bërë që pjesa më e madhe e tyre të përfshihen në Fjalorin e 1980 që është një vepër që pasqyron një shkallë të lartë të lëvrimin e të përpunimit të gjuhës.

b. Shumë prej fjalëve të këtij fjalori janë ngritur në nivel termash teknikë, duke u përfshirë në fjalorët terminologjikë.

c. Ka një numër të konsiderueshëm fjalësh, si fjalë - titull edhe fjalë që gjenden në shpjegimin e tyre që duhen vlerësuar duke i futur në përdorim ose për të zëvendësuar fjalë të huaja ose si emërtime të nuancave, të detajeve e të pjesëve të veçanta të sendeve, të objekteve etj., sepse ndjehen fjalë shqipe të motivuara ose të ndërtruara sipas mënyrave fjalëformuese të shqipes. Koha ka treguar se shumë fjalë që ndjeheshin dialektore, duke hyrë nëpërmjet fjalorëve në gjuhën e shkrimit, u ngritën në normë dhe u bënë pjesë e fondit aktiv të gjuhës. Të tilla ka ende në Fjalorin e Tases. Edhe frazeologjitë që nuk janë

---

<sup>10</sup> Shih më gjerë për këtë J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001

<sup>11</sup>J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 278

pasqyruar në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe<sup>12</sup> (1980), në Fjalorin e shqipes së sotme<sup>13</sup> (1984 / 2002) a në Fjalorin Frazeologjik të Shqipes<sup>14</sup> (1999) të Jani Thomait, dhe që natyrisht përbëjnë një fond jo të vogël, janë pasuri që duhet vlerësuar e përfshirë në fjalorët e ardhshëm të gjuhës, përfshi këtu edhe variante frazeologjike.

ç. Edhe rastet e veçanta në përdorimin e mjeteve fjalëformuese janë me interes e mund të shërbejnë si gjedhe për formime të reja. Duken me interes, sidomos për terminologjinë, edhe rastet e togfjalëshave apo shprehjeve me vlerë mbiemërore si: *i zënë goje, i mbë të kuq* etj.<sup>15</sup>

Shekulli XXI sikur ka ardhur me një hapësirë tjetër vlerësuese për veprat leksikografike të botuara para viteve 40 të shekullit të kaluar. Po ribotohen shumë fjalorë. Kështu po përmendim ribotimin e *Fjalorit të gjuhës shqipe* të vitit 1954, *Fjalorin e ri* të Nikolla Gazullit, është në proces *Fjalorthi i ri* i Pano Tases i plotësuar me rreth 500 e ca njësi të reja leksikore, semantike e frazeologjike. Nismën për botimin e dy fjalorëve të fundit, ndër të tjera, e ka ndër marrë edhe studiuesja Ledia Shamku që i ka pajisur të dy veprat edhe me nga një fjalë hyrëse. Ajo mban qëndrimin e vet, duke i rivlerësuar dhe duke i ridimensionuar pasurinë që ata pasqyrojnë. Me rastin e përgatitjes për shtyp të Fjalorthit të ri të P. Tases, në Parathënie e tij, ajo shprehet: “*Fjalët janë si monedhat*”, - thotë Saussure, - “*Vlera e tyre rritet vetëm nëse qarkullojnë*”. Ky aksion i ringjalljes së trashëgimisë sonë të vijuar, e sidomos të trashëgimisë që pasqyron drejtpërsëdrejti ligjërimin shqip (sikundër *Fjalori i Gazullit* dhe *Fjalori i Pano Tases*), synon t’ua ofrojë sërish përdoruesve të shqipes lëndën e sprovuar nga përdorimi faktik. Kjo lëndë, përmes një politike të kujdesshme gjuhësore, pa paragjykime laboratorike, mund ta zbusë standardin sot tejet të ngurtë, duke ia rritur natyrshëm atij shkallën e pranueshmërisë ndaj korpusit

---

<sup>12</sup> Fjalor i shqipe gjuhës së sotme, Tiranë, 1980

<sup>13</sup> Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984 / 2002

<sup>14</sup> J. Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, Tiranë, 1999

<sup>15</sup> H. Pasho, *Vështrim mbi leksikon krahinor të “Fjalorthit të ri”* të Pano Tases, SF, 3-4, 2001, f. 121

prej të cilit u krijua. Tek e mbramja, për çdo standard, shtegu i pasurimit për së brendmi ka rezultuar shtegu më i sigurt e më frutdhënës.

Përunjësia e këtyre mjeteve gjuhësore autentike, të cilat mbeten gjithnjë të gashme për t'iu dorëzuar shtysës së përdorimit sikundër edhe përunjësia e një mbledhësi të heshtur por të zot si Pano Tase, mund të induktojë po aq përunjësi në sistemin e vlerave të gjuhësisë shqiptare kur është fjala për çështje të gjuhës së përbashkët letrare. Për ta rifituar këtë dhunti të humbur, gjuhësisë sonë nuk i duhet të ecë më në shtigje revolucionare e as në shtigje që rrihen për herë të parë; asaj i mjafton një metodologji e saktë dhe e sprovuar, e ç'është më kryesorja, një vullnet i mbarë<sup>16</sup>.

---

<sup>16</sup> L. Shamku, Fjalori që këndon, Shekulli, 12 prill 2006



### KREU III

#### RRETH PASURISË LEKSIKORE TË “FJALORHIT I RI”

*Fjalorthi i ri* i Pano Tases ka mbi 2000 fjalë (Ledia Shamku pranon rreth 1600 lema<sup>17</sup>) dhe nëse mbështetemi te fjalori që është në proces botimi, do të kishim mbi tavolinë një vepër me mbi 2500 njësi leksikore. Këtë fjalës ne mund ta shohim në dy grupe të mëdha, në leksikun e përgjithshëm dhe në leksikun terminologjik, që për së shumti lidhet me mjeshtëritë kryesore të popullsisë së trevave të Përmetit a janë me terma për bimësinë a blegtorinë. Ka një karakteristikë dalluese për fjalorët dialektorë në përgjithësi. Hartuesit e tyre pasqyrojnë leksik jo vetëm krahinor e dialektor, por edhe mbledhjen e fjalëve (të mbështetur në pyetësorë të parapërgatitur ose jo), zakonisht e bëjnë sipas fushave tematike (konceptore e leksiko-semantike). Kjo del në pah kur mbledhës a grumbullues i kësaj pasurie mund të jetë dikush që nuk është as gjuhëtar, as specialist më i ngushtë (në rastin tonë terminolog a leksikolog). Kështu ka ndodhur edhe me Pano Tases që, si do të shihet në kreun për marrëdhëniet e leksikut të veprës së tij me leksikun e gjuhës standarde, u gjend në këtë sipërmarrje nga ndjenja e atdhetarizmit e jo nga profesionalizmi.

---

<sup>17</sup> L. Shamku, Fjalori që këndon (Parathënie e *Fjalorthit të ri* të P. Tases), Shekulli, 12 prill 2006

## A. LEKSIKU I PËRGJITHSHËM

Leksiku i përgjithshëm përmbledh fjalët e zakonshme të gjuhës së përditshme, të cilat përdoren në të gjitha fushat e jetës shoqërore<sup>18</sup>. Në Fjalorth ato nuk mungojnë. Autori i ka përfshirë sepse emërtojnë një nocion të ri a një nuancë të re kuptimore a gjallojnë në një fjalë fluturake, në një shprehje popullore a në një ndërtim frazeologjik, që nuk ai mendon se i përket të folmes së Përmetit, a lidhet me to.

a. Grupin e parë e formojnë një numër të vogël fjalësh që kanë karakter shumë të përgjithshëm. Sasia ka kushtëzim metodologjik. Autori me vetëdije kërkon të pasqyrojë në *Fjalorthin e ri* ato njësi që i ka vjelë si krahinore. Ato lidhen me nocione që mund të t'i përkasin botës materiale ose botës intelektuale dhe shpirtërore të shqiptarit. Ato u takojnë pjesëve të ndryshme të ligjëratës dhe mund të jenë emra, mbiemra, folje, ndajfolje, përemra etj. Kur të ndalemi te leksiku terminologjik (të cilin do ta shohim me hollësi), do të vërejmë se një pjesë e madhe e fjalëve që në Fjalorth mund të bëjnë pjesë në grup paradigmatic, është shterminologjizuar dhe në ditë e sotme është bërë pjesë e leksikut të përgjithshëm.

**Ah (-hu; ahet):** *shpagë (shpagesë) dëmi, ceni, dhune të shari, lëndimi zemre (nderi) etj. Sh.: marr (nxjerr) hakun; laj ahun.*

**Bar:** *Sh.: bar lëkure (shum: bar lëkurash) bartinjë; pluhur për të ruajtur lëkurat nga mijzat nga molat. Sh.: bar mole (shum: bar molash), naftalinë.*

**Bushtërë (-ra):** *qen femër me shtat të math, që mbahet për rojë shtëpije, vathi etj.*

**Dimërak:** *i dimërit § qemë që piqet vonë (në Vjeshtë) e që rron gjatë. Sh.: fik dimarak – fik i vonë. Dardhë dimarake – dardhë që piqet vonë dhe që ruhet gjithë dimërin.*

**Dimërore:** *e dimërit; për dimër. Sh.: rroba dimërore. Shtëpi dimërore – shtëpi për dimër, ku dimërojmë.*

---

<sup>18</sup> R. Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Tiranë, 2002, f. 151

**Ditëshkurtër (-ri):** jetëshkurtër; që nuk rron gjatë. § (si mallkim) që është më mirë të mos jet' i gjallë; t'i shkurtohen ditët; të vdesi.

**Elbishte (-ja):** kashta e elbit. § arë e mbjellë me elp.

**Flakërishta (shumës):** shkarpa, karthja të thata për të bërë, për të ndezur flakë.

**Gardhishte (-ja):** garth i vogël. Sh.: pulat na pjellin nëpër gardhishte.

**Gorricë (i -):** i fortë. Sh.: bëri top të gorricë – bëri top të hekurtë. Sh.: le të bënjë top të gorricë unë s'i trëmbem, un' s'ia kam frikën.

**Gumëzhinj:** oshëtinj; buçinj; gjëmonj; kumbonj; bënj zhurmë. Sh.: gumëzhijnë malet nga këmborët të bagëtive. Sh.: gumëzhin shtëpija nga kalamanjtë. Sh.: gumëzhin lumi, përroji – lumi përroji buçin, buxhin, oshëtin, gjëmon.

**Gurishtë (-shta):** gurishte; vënt plot me gurë, sidomos me gurë të vegjël.

**Gjumash (-shi):** njeri që i pëlqen gjumi, që fle shumë, gjatë; gjumëmath.

**Vogëlushe (-ja):** vogëloshe, çupë, gocë e voglë (për të përkëdhelur).

**Vërvitem:** hudhem; turrem; sulem; i derdhem; i vërsulem.

**Urovishtë (-ja):** arë e mbjellur me urof. § kashta e urovit.

**Zallishte (-ja)** tokë plot me zaje buzë lumenjvet.

Mendojmë se njësitë e mësipërme janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen se autori ka vënë një gur të rëndësishëm në regjistrimin e një pasurie të vlerësueshme kombëtare, që u përket fushave konceptore të ndryshme, ku jetonte jo vetëm përmetari, por edhe shqiptarët e tjerë, bashkëkohës të autorit të Fjalorthit, në hapësirat mbarëkombëtare.

b. Pano Tase me mëtimin për të mbledhur fjalë e shprehje që janë të rrethit të Përmetit a të hapësirave gjeosocioale përreth Përmetit, nuk jep si njësi të veçanta emërtime që lidhen me pemë shumë të njohura dhe që rriten në gjithë Shqipërinë, si *fik*, *dardhë*, *gorricë* etj., por emërtime të pathjeshta shprehje popullore, frazeologji që lidhen me këto me këto emërtime a me nocionet që shënojnë ato. Me të njëjtën dukuri do të ndeshemi edhe për kafshët, shpendët etj. shumë të njohur. P.sh. *fik* në *Fjalorth* nuk shpjegohet, por me

elementin plotësues *Sh.* (shembull) të çon te emërtimet e pathjeshta etj. Dhe jo të shpjegimi i vetë fjalës. Ky emërtim jepet në këtë formë:

**Fik:**

*Sh.: fik dimarak, shif: dimarak.*

*” fik dragotës, shif: dragotës.*

*” fiq të rreshkur – fiq të pjekur, të harrirë; fiqtë bullciqur.*

Për emërtimet **ferrë, pulë, gur, gjak**, si edhe për dhjetëra të tjera, ne do të gjejmë vetëm disa njësi frazeologjike (por edhe shprehje popullore), një pjesë e të cilave janë të perifrazuara a të shpjeguara:

**Ferrë:**

*Sh.: m’ubë ferrë me të grindurit e tij, me grinjën e tij, shif: grinjë, kokë (më hëngri -). Sh.: m’ubë ferrë, shif: vihem (m’uvu tepër). Sh.: çau ferrën (e hiku) – rojti; hiku fshehurazi; uarratis; shkoi për dushk; krisi e hiku nga friku; hiku pa vështruar prapa; mori sytë e hiku.*

**Pulë (-la):**

*Sh.: pulë bufkë, shif: bufkë.*

*” pulë kërpje – pulë e murrme me pendë të bardha dhe të zeza të përziara; pulë që s’është as e zezë as e bardhë.*

*” m’u si pula në mulli – mbyllur e skutitur (e thonë për ndonjë që rri mbyllur, që nuk del jashtë shtëpisë). Shif edhe shtëpi.*

*” (heshtëni, me aftë) se ha pula kos – se na dëgjojnë; se na kuptojnë; se na marrin vesht, se ha (se hanë me lugën t’ënë, se dinë, se kuptojnë gjuhën që flasim, anadja ta lëmë, ta këthejmë fjalën, të mos flasim më.*

*” ha pula gurë atje – është shtëpi e varfër, e vobegët, ku nuk gjen as pula kokrë për të ngrënë.*

*” ugënjye si pula me drudhe – uzu në lak, ufut në thes për gjepura; la ta gënjejnë si ç’gënjehet pula me kokra, me thërrime.*

*” e çokitnë pulat – e quknë me qep, me sqep pulat (për sende që i kanë qukur pulat o që duken si të çupitura)*

**Gur:**

*Sh.: s'la gur pa lëvizur – s'la gjë pa bërë, sidomos për të bërë të prapën, për të bërë ndonjë punë të papëlqyer.*

*Sh.: s'la dy gurë bashkë - s'la gur pa lëvizur.*

*” s'la gur mbi gur - s'la gur pa lëvizur.*

*” s'la dy gur pa lëvizur për ...; dha bot e bot për të ...; upërpoq shumë për të ...*

*” han pula gur atje, shif: pulë (han pula).*

*” është gjarpër i gurëve, shif: gjarpër.*

*” mbeti si guri në mes të pellgut, shif: pellk.*

### **Gjak:**

*Sh.: i ra gjaku ndër këmbë – për një njeri që lodhet shumë me punë, që s'e lë puna të rrijë, që është gjithë ditën mbë këmbë me punë, që i janë këputur kryqet nga puna; uloth, ukëput nga puna.*

*” i ra gjaku ndër këmbë – u sëmur, pësoj nga këmbët, sepse qe i shtrënguar të rrijë më këmbë pa lëvizur vëndit. Shif: varavingë.*

*” më prishi gjakun – më llamanisi; më sëmuri; më helmoj; më bëri të helmohem, të brengosem; më plasi buzën; ma shpuri buzën te veshi,; ma shpuri barkun prapa.*

*” ma bëri gjakun ujë - më prishi gjakun.*

*” më ngriu gjaku ndër dej (në deje) – m' upre fuqia; m' uprenë këmbët; më ngriu zemra nga frika; utrëmba tepër; ngriva nga frika; më shkoj (më la) zëmra nga frika; m' uzu, më hiku fryma nga frika.*

*” uskuq, ubë gjak i kuq, shif: skuqem.*

*” të merr gjak në vetullë – është tepër i zoti; i squat; i vjen dore tepër, është dorëdjathtë.*

*” gjaku s'bëhet ujë, shif: mish.*

*” e bënë e përmori gjak, shif: rrah.*

*” gur gjaku – gur i kuq për unaza.*

## **B. LEKSIKU TERMINOLOGJIK**

Leksiku terminologjik përmbledh fjalët që përdoren në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore sipas mjeshtrëve dhe që njihen dhe përdoren vetëm nga grupe të caktuara njerëzish, nga punonjës e specialistë që merren me një punë të caktuar<sup>19</sup>.

Në vazhdim do të japim grupet kryesore tematike të leksikut të Fjalorthit, duke dalluar brenda çdo grupi paradigmatic fjalët që i përkasin leksikut të përgjithshëm, që mund të shihen edhe si leksik mbarëkombëtar, dhe fjalë që janë thjesht terma të përdorur në një areal shumë të ngushtë.

### **FUSHAT KRYESORE KONCEPTORE, LEKSIKORE DHE SEMANTIKE**

Studimet gjuhësore në rrafshin e semantikës e të leksikografisë strukturore sot nuk mund të arrijnë përfundimet e dëshiruara pa interpretimin e lëndës leksikore e semantike përmes teorisë së fushave konceptore e leksikore e semantike. Kjo bëhet e domosdoshme për lëndën e një fjalori i cili siç thotë J. Trieri mund të konceptohet si një zinxhir me shumë hallka e ku çdo hallkë përbën një fushë të mëvetësishme, por që lidhet me hallkën (fushën) tjetër nga elemente të dhënë<sup>20</sup>. Ky lloj këndvështrimi bëhet i detyrueshëm veçanërisht kur jemi në fushën e terminologjisë. “Veçoria e pasurimit të leksikut me krijime sistemore është më e theksuar në terminologjitë e degëve të ndryshme të shkencës dhe të teknikës, të cilat funksionojnë në leksikun e përgjithshëm terminologjik si sisteme të organizuara, të lidhura e të bashkëkushtëzuara në përputhje me sistemet konceptive të fushave përgjegjëse. Nga kjo pikëpamje

---

<sup>19</sup> J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 1999, f. 242

<sup>20</sup> Shih më gjerë J. Thomai, Prejardhja semantike në gjuhën shqipe, Tiranë, 1989, f. 70-71; V. Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejprësorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër, 1999, f. 24-46.

leksiku terminologjik dallohet për karakterin e tij më sistemor e më të organizuar se leksiku joterminologjik”<sup>21</sup>. Dhe në *Fjalor* kemi një numër të madh emërtimeve që mund të shpjegohen dhe të interpretohen si terma brenda sistemeve të ndryshme terminologjike. Por kurrsesi ne nuk mund të gjejmë aty sisteme terminologjike, si i parashtrohet studiuesi A. Duro a si mund t’i gjejmë ato në fjalorët terminologjikë të ditëve tona, të botuar nga studiues të veçantë<sup>22</sup> a nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Njihet pak a shumë zhvillimi i Shqipërisë dhe i qyteteve shqiptare deri në mesin e shekullit XX, për rrjedhojë edhe zhvillimi i qytetit të Përmetit. Jemi më pranë mjedisit fshatar në gjithanshmërinë e jetës së përmetarit. Ndaj është më se e arsyeshme përse pjesa më e madhe e fjalëve të mbledhura nga P. Tase vjen nga ky mjedis. Ne po e ndjekim subjektivisht këtë linjë interpretimi të lëndës leksikore, semantike e frazeologjike të *Fjalorthit të ri*, duke kërkuar fusha konceptore e leksikore që lidhen veçanërisht me jetën në fshatrat përreth qytetit buzë Vjosës.

Kështu ne do të shohim fusha të ndryshme emërtimeve (a termash) që lidhen me bimësinë, me gjitarët, me shpendët, me insektet dhe aty këtu edhe me zejtarinë e zejtar kryesorë që ishin karakteristike të jetës së banorit të atyre trevave në kohën kur mbledhej lënda që më vonë do të pasqyrohej në faqet e fjalorit.

---

<sup>21</sup> A. Duro, Terminologjia si sistem, Tiranë, 2001, f.9

<sup>22</sup> Shih më hollësisht për këtë edhe M. Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, në “Dialektologjia shqiptare”, 1, Tiranë, 1971; V. Memisha, Emërtime për kafshë e shpendë në Labëri, Gjirokastër, 1999; N. Mërkuri etj., që kanë mbledhur leksik terminologjik nga trevat e Jugut.

## EMËRTIME LULESH

Si do të shohim për të gjitha fushat leksikore që lidhen me bimët dhe kafshët (dhe në të cilat do të ndalemi në vijimësi), Pano Tase na sjell emërtime që mund të përfshihen në dy nëngrupe më të vogla, por që kanë një numër të konsiderueshëm njësisish:

a. në emërtime (a terma) që lidhen me bimësinë e kultivuar (me drithërat e bukës, me pemët frutore etj.) a me kafshët e mbarështuara (që mbahen si kafshë transporti a për mish, qumësht, lesh pleh etj.) ;

b. në emërtime (a terma) që lidhen me bimësinë a me kafshët e egra, që rriten në gjirin e natyrës dhe me të cilat është lidhur pandashëm jeta e njeriut jo vetëm në trevat e Jugut dhe të Përmetit.

Le të ndalemi në disa prej tyre:

### a. Emërtime për lule e barishte të kultivuara

Fusha leksikore e emërtimeve për lulet është e vogël, si nënfusha për lulet e kultivuara ashtu edhe për ato të egra. Mbase autori i ka anashkaluar këto me vetëdije. Te materiali “Mjekësia popullore” që e ka lënë dorëshkrim, kemi shumë emërtime që lidhen me bimët dhe lulet shëruese. Ato duhen vjelë në një punim më të gjerë më të plotë.

*labot (-ti): labotë; lakrurinë me gjethe të gjëra që e bëjnë lakruar.*

*Landro (-ja): landrë; marshallojë; lulenishte.*

*Landrovidhe (-ja): londrivan; rosmari.*

### b. Emërtime për lule e barishte të egra

*Akës, (-si) Sh.: lule akësi - - lule e verdhë mali, me të cilën thurin kurora dhe kryqe për kishat, sepse duron gjatë.*



**Dredhëzë** (-za): barishte e gjatë si kulpër, që hipën, që ngjitet tuke udredhur mbi drurë.

**Grashinë** (-na): barizhdë e egër që rritet ndëpër ara në dëm të të mbjellavet, bën një kokrë si urofi.

**Korkoshanë**: luleja e lojfatës që varet si vëth; këto lule të kuqe në krye bëhen pastaj si cironj, si karumbe të thata; bishtaja lojtare.

**Vulër** (-ri): krisje e gjatë; barishte e egrë, e dëmëshme për të mbjellat, me rrënjë më të trasha se të krisjes, dhe gjethe e farë si të pshesës.

## EMËRTIME PËR BIMË E PEMË

### a. Emërtime për pemë të kultivuara

**Çortës** (-si): emër një dore fiqsh të ëmbël. Sh.: çortës i bardhë. Sh.: çortës i zi.

**Erdhi** (-ja): hardhi vreshti.

**Erdhishte** (erdhishtet): dega hardhije të prera.

**Bishteze** (-za): pemë me bisht më të gjatë nga ç'e ka dora e saj prej fisi. Sh.: dardhë bishteze - - dardhë bishtje; dardhë me bisht më të gjatë nga ç'e kanë ndormazi dardhët.

**Dragotës**: emër fiku në Përmet. Sh.: fiq dragotës.

### b. Emërtime për pemë të egra

**Beduicë**: shkarpë e vogël që rritet gjer gjysëm metre.

**Bujgër**: lis i butë, dushk i butë me gjethe të gjera.

**Bushqan** (-ni): bimë e mblërme ver'e dimër, gjethe si të rrumbullakta, që ngjitet pas mureve e pas lisave; i shëmbëllen kulprës.

**Cërmëdell** (-lli): dru lëndë pylli gjer 2 - 3 metërash të gjati, me zemër të verdhë.

**Ëngjërdishte** (-ja) bimë shkarpë me purteka (me dega) të gjata dhe të holla që përdoren për të lidhur pemë të vogëla a hardhija pas hujvet.

**Frashnjë (-nja):** dru frashëri,; frashër.

**Kuçumare (-ja):** pema e mares, që është si lyshtydhe e madhe dhe e kuqëreshme.

**Lërushk (-ku):** rrush i egër, rrush gardhi, rrush koqevogël dhe i tharët që sije bëjnë uthullë. Shif: larushk.

**Lofatë (ta):** dru me gjethe të mëdha, me lule të gjata në nghjyrë të kuqërreme dhe bishtaja me farë që kur thahen, shëmbëlajnë me bishtajat të karrumbës së egër, të bridhiut, dhe quhen korshane; lojfatë; lajthatë; lofashtë.

**Manëzë (-za)** pema, kokra e manit.

Sh., urrahnë u bënë manëza, shif: rrihem.

” e rrahu e bëri manëza – ekëputi në dru, e kalbi së rrahuri.

## EMËRTIME KAFSHËSH (GJITARË)

Ledia Shamku pohon se “tek emërtimet zoologjike ky Fjalor paraqitet hera-herës edhe më i shkoqur e më i saktë se pasardhësit e tij. Lidhur me këtë epërsi aspak të rastësishme vlen të përmendet se në arkivin e etnologjisë sot gjendet një dorëshkrim i plotë i Pano Tases titulluar “*Blegtoria në Lëshicë*” (1975). Kështu Tase saktëson se lema *balo* shenjon “qenin me ballë të bardhë” dhe jo “kaun e bardhë” siç del te *FGJSH*. Për këtë të fundit Tase ofron lemën *bardhoç*. E njëjta gjë paraqitet me lemën *bal* e cila këtu ka shpjegimin “dash i zi me ballë të bardhë”. *FGJSH* e shpjegon si “qen me njolla të bardha, lingua”, ndërsa te *FGJSSH* kjo lemë nuk rezulton”<sup>23</sup>.

Para se të parashtrojmë 2 fushat kryesore leksikore të emërtimeve që lidhen me kafshët gjitare, duhet të theksojmë se emërtimet për kafshët e buta në fshatrat shqiptare janë me dhjetëra e me dhjetëra, për të mos thënë me qindra. P. Tase ka mbledhur emërtimet për kafshët shtëpiake për zonën e Leshicës (“*Blegtoria në Leshnicë*” (1975), 82 f.) dhe ka sjellë me qindra të tilla. Arsyeja e numrit të shumtë të të njëjësive të këtij grupi qëndron në dukurinë se çdo gjë e

---

<sup>23</sup> L. Shamku, Fjalori që këndon (Parathënie e *Fjalorthit të ri* të P. Tases), Shekulli, 12 prill 2006

gjallë për fshatarin duhet të shenjohej me një emër të veçantë, ashtu si shenjohen edhe njerëzit.<sup>24</sup> Por si do të flasim në një syth të veçantë, kur jep emërtimet e kafshëve të buta, P. Tase nuk ndalet te emërtimet e njohura në mbarë shqipen, por vetëm tek ato që mendon se janë të kulturës përmetare. Ai ka meritën se jep shumë përdorime dyshe: emërtimin e pathjeshtë / emërtimin njëfjalësh. Shembujt me **dele, dhi, lopë** etj., e tregojnë më së miri këtë prurje.

### a. Emërtime për kafshë të mbarështuara

Po japim një numër të vogël njësisish për kafshë të mbarështuara a të egra, nga dhjetëra e dhjetëra që janë në *Fjalorthin e ri*:

**Baliskë:** (fjalë bagëtiye) Sh.: dhi baliskë - - dhi që ka ballët të bardhë.

**dhi balë,** shif: balë.

**dhi barxhë,** shif: barxhë.

**dhi breskë,** shif: breskë

**dhi çaponjë,** shif: çaponjë.

**dele çullë,** shif: çullë

**dele llajkë,** shif: llajkë.

**dele kaleshe,** shif: syskë; kaleshe

**dele llajë,** shif: llajë

**dele syskë,** shif: syskë.

**dele vakërë,** shif: vakërë.

**Çullë (-lla):** dele me veshë të shkurtër.

**Enjë (-nja)** dhi që ka shtyrë o që i ka ngordhur keci. Sh.: dhitë enja nuk e presin qumështin.

**Kapuç (-qi):** kërr; gomar; gazhel.

**Vakrë (-ra)** dele që ka turinjte me ngjyrë të ndryshme nga ngjyra e trupit, sidomos turi të zi a të verdhë me trup ngjyrje të ndryshme.

---

<sup>24</sup> Shih më gjerë Gj. Shkurtaj, Emrat e kafshëve sipas ngjyrës, SF, 1, 1971; V. Memisha, Emërtime për kafshë e shpendë në Labëri, Gjirokastër, 2001.

*Xërbë (-ba): dele a dhi plakë e pavleftë as për qumësht as për mish se nuk ka si mahet.*

*Xhave (-ja): qen që len mbë të kotë; qen që s'i mbyllet goja, që s'pushon së lehuri. Sh., ç'ka xhaveja qe leh.*

#### **a. Emërtime për kafshë të egra**

Në Fjalor është grupi më i vogël i emërtimeve, por jo i painteres.

*balëdosë: kafshë e egër nga shtati sa një qen, me qime të murme; me copë lëkure balëdose sbukurojmë kapistrat dhe frënjt të kuajvet për të mos marur sysh, baltëdosë, dosbalëzë.*

*Dredhës (-si): dre (drë) me brirë të dredhur, me brirë me dega.*

### **EMËRTIME SHPENDËSH**

Fusha e emërtimeve për shpendët e egër është më e madhe se ajo e emërtimeve për shpendë të butë. Arsyet janë dy: shpendët e egër janë më të shumtë njëllojshmëri ndërkohë që emërtimet e tyre janë më pak të njohura për shqipfolësit jashtë hapësirave përmetare.

#### **a. Emërtime për shpendë të butë**

*bufkë (-ka): Sh.: pulë bufkë - - pulë më shumë pendë, me kaçlutë, me xhufkë pendësh mbi krye. Sh.: pulë bufkë - - pulë me këmbët të mëveshuar me pendë; pulë e mbathur; pulë me brekë.*

#### **b. Emërtime për shpendë të egër:**

*Bishmakuqës (-si) zok fluturak, shpent i vogël me bisht si në të kuqërremë.*

*Cëqe (-ja): shpent i murëm, i hirët, me trup sa një qlëofkë; mëllënjë.*

**Cëre (-ja):** shpent si cëqeja, në ngjyrë të hirit dhe me pikëla në bark.

**Cinxami (-miu):** zok rrodhëze; zok rrodhës; fluturak i vogël që ka cakun ndër ferra, ndër gjerdhe. Sh.: cinxamiu i ferrave.

**Çafkëlore (-ja):** shpent ngjyrë hiri me një tufë pendë si hufkë mbi krye.

**Çilingë (-ga)** shpent i vogël i fushës ngjyrë hiri mbë të bardhë. Sh.: çilingaështë miqeshë e bujkut që nget nd'arë.

**Drenjë (-nja)** shpent i vogël, me krahë të murrët dhe trup të kuq të verdhë.

**Kryartëzë (-za):** shpent i vogël me kokën të kuqe.

**Kukumjame (-ja):** kukuvajë; kukumjaçkë.

**Lylyk (-ku):** shpent sa mëllenja; rron në kope dhe emëri i ka mbetur nga zëri që bën: ly-ly-ly.

**Xborakës:shif:** sborakës

## EMËRTIME INSEKTESH E AMFIBËSH

**Cinxërë (-ra):** gjinkallë.

**Gëlistrë (-ra):** krimp i hollë dhe i gjatë që rron në vende të lagësht ndënë gurë, ndë pleh etj.; lakmojnë pas sije pulat dhe e gjuajnë peshkatarët për të kuar gërjepat.

**Xeglë (-li):** xegal, mizë që u bije mbë qafë qevet sidomos në vapë.

Sh., kur i piskon xegli tërbohen qetë dhe munt të thyejnë parmëndën.

**Karkëzozë (-za):** bretkosë, zhabë.

## EMËRTIME ZEJESH E VEGLASH PUNE

**Avlëmënt (-ndi):** vek, vegël për të endur sidomos tesha të shtruari, samarskutë, fanella, shajkë.

**Filiç:** tundësi i trobolocës; një bisht i drunjët i gjatë me një rrotullame (rutullame) të drunjët për së fundi, për të tundur qumështin në trobolicë, për të bërë gjalpët.

**Kosore (-ja)** kosërë; kostrë; kosë për të kositur.

**Rrumbë** (-ba) pykë e vogël e drunjtë për të lidhur, për të mbërthyer dy pjesë druri, sidomos të parmendës o të veglave t'jera bujqësie.

**Gojëzë** (-za); ngoje, ngojezë; lak tërkuzë që i shkojnë nofullës së poshtëme të kafshëve të barrës, që të mos mundin të hanë gjatë rrugës, sidomos kur janë ngarkuar me bar o me duaj gruri o koqinash të t'jera.

**Veshzë** (-za): pjesë e parmendës për të hequr vijat mbi të cilat mbillet misëri ose për të prerë lehet arës së mbjellur.

## EUFEMIZMAT

Pano Tase nuk ka lënë pa grumbulluar edhe disa eufemizma, edhe pse nuk e përdor këtë term. Interesant është se ai ndalet te kjo veçori e gjuhës dhe na na jep informacion sociolinguistik e etnolinguistik. Le ta shohim këtë dukuri drejtpërdrejt të fjala **vdes**:

### **Vdes:**

*Shënim: Gjindjes s'ënë nuk i vjen mirë kur të kujtonjë drejt për së drejti fjalë me kuptim të papëlqyer, të prapë; i duket sikur ndjell të zezën, prapësirën, kur i zë në gojë edhe vetëm emërin, andej druajnë të thonë: vdekje, mortje, vdiq, etj. si këto; më të shumtën e herës përdorin mënyra të tërthorta si:*

**shkoj – dha jetën – dha frymën – ndërroj jetë – unda prej nesh – unda (prej) kësaj bote – unda (prej) kësaj jete – neve shëndoshë – e ndjeu Perëndija – shkoj në atë botë** etj. etj.

Sa për njerëzit të poshtërë, të trshë, të pagdhendur, këta, po nga ndonjë herë dhe palët e qytetëruara, kur është puna për të përçëmuar, përdorin mënyra të thëni si:

**e pështeti brinë, brinjën – e nguli brinë, brinjën – e bëri sheshin brek – bën ponica – e hodhi topin – na e la bukën – i usosën bukët – e drodhi bishtin** etj. etj.

*Sa për njerës të njohur për ligësi shpirti përdorin:*

**na e mori të keqen – ngordhi – cofi – i hodhi patkonjtë** etj. etj.

Në Fjalorth kemi shumë emërtime-emra, që dalin me këtë funksion:

**Çqoftua:** *sqoftua (mos qoftua); i paudhi; i mallëkuari; i qoftëlargu; i panakarmi; i përroit; i lumit.*

**Gojëmbërthyer (-ri):** *ujku, i pagoji, bisha e pagojë.*

**Veshëndelezë (-za)** *bishë, egërsirë a kafshë e përrallët që ha njerës; shif: katravesh; lufosë.*

**Katravesh (-shi):** *bishë e përrallavet të vjetra që ha njerës si kulshedra.*

**Karakashinë (-na):** *eth o qenq që nuk ka ardhur i mbar, që nuk bën të rritet, që ka ardhur i rrëgjuar.*

## PATHIRRMAT

Një grup paradigmatic njësisish me interes studimi në Fjalorth është dhe ai i pasthirmave nxitëse (edhe pse në pamjen e parë duket se dalim nga objekti i studimit, ne po e japim lagjen e tyre të plotë). Në Gramatikën e gjuhës shqipe, botimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë thuhet se: “Një vend të veçantë ndërmjet pasthirmave nxitëse zënë ato me anë e të cilave ndjellim a ndërsejmë kafshët, i frikësojmë ose i nxitim për fillimin, ndërprerjen, vijimin ose përfundimin e një veprimi të tyre. Disa prej këtyre pasthirmave, kryesisht ato me të cilat u drejtohem kafshëve shtëpiake, e kanë pak a shumë të përcaktuar përbërjen fonetike, sidomos në fushën e përdorimit”<sup>25</sup>.

Pano Tase jep shumë njësi të tilla që lidhen me të ndjelljet në botën e kafshëve dhe të shpendëve, që japin dorë për një interpretim sociolinguistik, etnolinguistikë a gramatikor. Po japim disa prej tyre:

**Ndjell:** *therres bagëtinë, qentë, kafshë t’jera të mblidhen, të më vijnë afër. (Shënim: gjindja përdorin zërëra të ndryshme për të ndjellur çdo dorë kafshësh; gjithashtu bënë dhe për t’i përzënë).*

*Për macet: mac – mac, makërr – makërr; pës – pës.*

*(për t’i përzënë: pist – pist; çit; çit – çit).*

*Për qentë: na –na; kuet – kuet; dhe për femrat: na - buçe – na.*

*(për t’i përzënë:hajt – hajt; osht; hosht; osht – osht; hosht – hosht).*

---

<sup>25</sup> Gramatika e gjuhës shqipe, 1. Tiranë, 2002, f. 435.

*Për kujat dhe pelat: na – kër – na; rër – na).*

*(për t'i ngarë, për t'i ndjekur: deee).*

*Për mushkat: na – muçe – na.*

*(për t'i ngarë: muç – muç).*

*Për kërrat: kër – kër, kiç – kiç.*

*(për t'i ngarë: ysh – ysh).*

*Për pulat: kërr – kërr; tigëti – tigëti.*

*(për t'i ndjekur a për t'i tërbuar: ush – ush; çoo – çoo).*

*Për kllloçkat: koç – koç – koç.*

*(për të tërbuar pulat e huaja: e botës – e botës; botës – botës; bocë - bocë).*

*Për zogjtë e kllloçkës: ci – ci – ci.*

*Për të ndjekur, për të tërbuar gjeraqinat: huj; huj – huj.*

*Për bletën: hajde marro – hajde bijë.*

*(për t' e shtënë në krinë të re, pas si të fërkojnë krinën me pshelinok përpjekin dy gurë ndër duar dhe thërresin: hajde marro në shtëpin' e re – në shpin' e re).*

*Për lopët: ptruo – ptruo; loko – loko; myyy.*

*(për t'i ndjekur: ho – loksh; ho – ho).*

*Për viçat: çoke – çoke.*

*(për t'i ndjekur: ho – loksh).*

*Për dhitë: tuh – tuh – tuh.*

*(për t'i ngarë: cij – cij; cog – cog; stigaj).*

*Për kecat: kece – kece – kece.*

*(për t'i ngarë: kece – kece – meee).*

*Për delet: ty; try; ptry; tyty; ptry – ptry.*

*(për t'i ngarë: rrër, rrë, rrët).*

*Për të ndërzyer qentë: o derra, o dos; o desa murk; sëss.*



## KREU IV

### RRETH PASURISË FRAZEOLOGJIKE TË “FJALORTHIT I RI”

#### A. PASURIA FRAZEOLOGJIKE

Studiuesi e leksikografi J. Thomai pranon që “njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënuese me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme”<sup>26</sup>. Duke u mbështetur në këtë koncept për njësinë frazeologjike pasurinë e Fjalorit, përveç fjalëve e ndajmë lehtësisht në dy grupe të mëdha paradigmatiche:

- a. në frazeologji të mirëfilltë
- b. në shprehjet popullore.

Njësitë që përbëjnë këto grupe janë me qindra. Për mendimin tonë është pjesa më me vlerë e Fjalorthit të ri. Ato nuk vinë vetëm me vlerat leksikore e semantike, por edhe me vlera të jashtëzakonshme etnolinguistike. Po renditim më poshtë disa nga njësitë frazeologjike të pasqyruara në vepër:

(kjo shtëpi shkoi) *dorë më dorë* (ndërroi zot shumë herë, ushit dhe uble shumë herë); *na puthi dorën / na la shëndet / na mori të keqen* (vdiq, ngordhi) / *i lamë duart sije* (na mori të keqen) / *më ra në dorë / vura, shtira në dorë / më erdhi në dorë / më vuri në dorë / më futi në thes; më shtyri në lak; me dorë në zemër; nuk merr faj përsipër / zoti vëntë dorë (e na e shpëtoftë); mos i ep çikë* (mos e ngacmo) / *mos i çil shtek; i dha dërrmën / i vuri dockën / i vuri gishtin; të mban goja era qumësht, m’u mjak goja, m’u tha goja, m’u lodh goja, bëri gojë të hekurtë, bëri top të gorriktë, u vranë me gisht; u bë gjak i madh, ubë gjaku gjer në gju, punë me gëzhdalla, s’la dy gurë bashkë / s’la gur pa lëvizur / s’la gur mbi gur, han pula gur atje, është gjarpër i gurëve, mbeti si guri në mes*

---

<sup>26</sup> J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 1999, f. 211

të pellgut, i ra gjaku ndër këmbë, më plasi buzën; ma shpuri buzën te veshi, ma shpuri barkun prapa, ma bëri gjakun ujë, më prishi gjakun, më ngriu gjaku ndër dej (në deje), m' upre fuqia; m' uprenë këmbët; më ngriu zemra nga frika, më shkoj (më la) zëmra nga frika, më hiku fryma nga frika, ubë gjak i kuq, të merr gjak në vetullë, i vjen dore tepër, gjaku s' bëhet ujë, e bënë e përmori gjak, gur gjaku (gur i kuq për unaza) etj.

Paraqitja leksikografike e frazeologjisë është e kushtëzuar nga gjymtyra kryesore që motivon njësinë. Kjo çel edhe udhën për paraqitjen e njësive frazeologjike edhe në fjalorët e mirëfilltë shpjegues të shqipes që do të botohen më vonë. P.sh., **Zemrë** jepet me një fushë leksikore (frazeologjike) me 17 njësi të drejtpërdrejta dhe me 12 të tjera që shpjegojnë këto, pra me rreth 30 njësi.

### **Zemrë:**

*Sh., më theri në zemrë – më piku; më pikëlloj mu në zemrë.*

*” më ra si plump në zëmërë – më erdhi shumë rëndë; më pikëlloj fjala, lajmi që dëgjova. Shif: plump.*

*” më dolli nga zemra – m' umërxit; m' uzvorth nga zemra; s'e kam më në pekul si ç'e kam pasur; m' ubë i mërxitur.*

*” m' ushndrit zemra, shif: bark (më mori barkun).*

*” më shkoj zemra nga frika, shif: gjak.*

*” më drithëron zemra, shif: drithëronj.*

*” ma hoqi zemra – ma deshi, ma kërkoi zemra, m' utek për ...: ma dëshiroj zemra; më mori malli për ...*

*” më pshon zemra brënda – më lëndohet, më pikëllohet zemra; më bëhet zëmra vrer.*

*” në mos mallkoftë goja do të pshonjë zemra brënda.*

*” s'ma heq zemra – s'ma do zemra; s'ma pëlqen, s'ma duron zëmra.*

*” me dorë në zemrë i rri të zotit akëcili – me drojë; me të druajtur, me binduri të madhe, me besë.*

*” ma gjeti zemrën – më bëri volltën (sidomos pa ja kërkuar unë një gjë); ma bëri vullnetin; më bëri atë që më donte zemra.*

*” m' ubë zëmra mal, shif: mal.*

*Punon me zemrë të thyer – nuk i vë zemrën punës; nuk i vën kujdesën që duhet punës; punon (si) me pahirë; s'ja ka zemrën punës.*

*” ma bënë zemrën flutura kalamanjtë, shif: flluguronj.*

*” në zemrën e dimrit, shif: palcë.*

**Semantikisht** njësitet frazeologjike, që gjenden në *Fjalorthin e ri*, u përkasin nocioneve të ndryshme. Ato kanë të përhershëm ngjyrimin emocional dhe që të gjitha vinë nga shndërrimi figurativ i togfjalëshave që shprehin lidhje nocionore (në shumicën më të madhe nga jeta materiale dhe nga bota fshatare) nga mendësia shekullore e përmetarit. Sipas motivimit semantik, ato ndahen në dygrupe të mëdha:

a. nga shndërrimi i figurativ i një togfjalëshi të lirë frazeologjik: *nuk i zënë këmbët dhe, më mori lumi; mori porrotinë, nuk e vë ujët në zjarr, ra nga shkallët* etj.

b. nga shndërrimi figurativ i një togfjalëshi që ka në përbërje një gjymtyrë të metaforizuar, d.m.th., krijohen njësi frazeologjike duke mos patur togfjalësha të lirë përgjegjës: *u bë erë , u bë veri, e preu e zeza, punon me zemër të thyer; s'ma heq zemra; më plasi shpirti* etj.

Figura kryesore gjuhësore që realizon shndërrimin figurativ është metafora foljore: *më ngriu zemra, m' ushndrit zemra* etj.

Një nga dukuritë më interesante në *Fjalorth* është **sinonimia frazeologjike**. Pano Tase jep me dhjetëra vargje sinonimike me njësi frazeologjike, duke treguar njëkohësisht edhe pasurinë por, edhe variacionin e të folmes përmetare dhe të vetë shqipes në këta fushë. Shembujt emëposhtëm e tregojnë më së miri këtë: *më plasi buzën / më prishi gjakun (zemrën) / më plasi shpirtin / ma poqi peshkun në buzë / ma shpuri buzën te veshi / ma plasi vrerin / më vuri në mundim; me buzë të plasur / me zemër të helmuar* etj.

Në Fjalor nuk gjejmë dukurinë semantike të antonimisë frazeologjike, po kështu edhe atë të polisemisë.

Duke u mbështetur te **modelimi strukturor**<sup>27</sup> në përgjithësi njësité frazeologjike në *Fjalorthin e ri* i kemi me strukturë togfjalëshi: *s'i hapet barku; i hëngri veshët; iu pre koka, e mori në bisht, s'të bie bishti* etj.

Por aty këtu gjejmë edhe ndërtime me strukturë fjalie: *më ra ngjirithi së foluri* etj.

Sipas **modelimit leksiko – gramatikor** në *Fjalorthin e ri* gjejmë njësi frazeologjike të barasvlershme:

**me një folje:** *më shkojnë purteka trupit; më qau gërmadha; më preu e zeza; në qafë pastë vehten, ubë ftua* etj.

**me një emër:** *vandak me dru, plënk në zemër* etj.

**me një mbiemër:** *koskë e lëkurë* etj.

**me një ndajfolje:** *del e dukë, erë më erë, cak mbë cak* etj.

Ne mund të vazhdonim me veçoritë leksiko –gramatikore të gjymtyrëve të njësive frazeologjike, por mendojmë se do të biem në hollësi që mund t'i vështrojmë më hollësisht në një punim më të gjerë.

---

<sup>27</sup> J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f.

## B. PASURIA E SHPREHJEVE POPULLORE

### PËRSHËNDETJET

Përschëndetjet janë një dukuri njerëzore e përgjithshme. Nuk ka bashkësi njerëzore që nuk i përdorin ato. Por me keqardhje vërejmë se në *Fjalorthin e ri* nuk kemi gjetur të tilla. Ne kemi parë jo vetëm përkushtimin e P. Tases për t'i mbledhur shprehjet popullore, por edhe aftësinë e intuitën për të gjurmuar atë që është vetiake për krahinën e Përmetit. Mbase mosprania e tyre në vepër ka qenë e pavetëdijshme, ose ngaqë përschëndetjet mund të jenë të njëjta me ato të shqiptarëve të tjerë.

Gj. Shkurtaj, në veprën “Etnografi e të folurit të shqipes”, është marrë gjerësisht dhe gati – gati shterueshëm për këto ndërtime (konstrukte) që hyjnë gati të gatshme gjatë aktit të komunikimit, duke i parë ato në rrafshin e kulturës botërore dhe asaj kombëtare. Përschëndetja, - thekson ai, - në përgjithësi është shprehja gjuhësore paraprake apo e zanafillës për çdo ndërschëmbim kulturor: ajo pasqyron një traditë të lashtë sa vetë njeriu, domethënë të drejtuarit me fjalë dhe nisjen e një komunikimi të vërtetë midis dy vetëve; ajo është pikënisje për komunikim dhe , prandaj, ka një funksion të rëndësishëm gjuhësor<sup>28</sup>.

### URIMET

Gj. Shkurtaj pranon se urimi, nuk është gjë tjetër veçse një akt i të folurit që shpreh një qëndrim ndaj sjelljes dhe fatit të të tjerëve. Ky studiuues e ffillon më tej konceptin për urimin, duke nënvizuar se ai është shprehja e një dëshire me fjalë, që pritet të realizohet në një kohë të ardhshme. Urimi, sipas tij, mund të shprehet me shumë lloje formulash rituale që ndryshojnë sipas ndjenjave dhe situatave<sup>29</sup>.

---

<sup>28</sup> Gj. Shkurtaj, Etnografi e të folurit të shqipes, Tiranë, 2004, f. 111

<sup>29</sup> Gj. Shkurtaj, Etnografi e të folurit të shqipes, Tiranë, 2004, f. 145

Në *Fjalorthin e ri* gjejmë përsëri një lagje të tërë urimesh (51 të tilla), të mbledhura e të përzgjedhura me kujdes. Po e japim atë të plotë:

**Urime:** *Urimet, mu si mallkimet (shif: mallkime) janë të shumta në shqipen; çdo krahinë ka të vetët, të panumurtë; këtu pas po shënojmë një pjesë të urimevet që përdorin sidomos grarërija në rrethin e Përmetit. Shumica e këtyre urimeve kupëtohen vehtiut pa nevojë tfillimesh të gjatë.*

*Ardhsh për shumë vjetë.*

*Ardhsh edhe me nuse (për të pamartuar).*

*Ardhsh edhe me djem (për të rinj a për të ra që nuk kanë edhe po fëmijë).*

*Ardhsh edhe me nuset e djemëvet (për ndonjërën të shkuar nga mosha).*

*Në dasmë të djemet (të djemvet).*

*Në dasmë të fëmijës.*

*Thela në darsmë, në dasmë (urim për të pamartuarët).*

*Të hëngshim dasmët.*

*T' ulumtë dora (për ndonjë punë, për ndonjë shërbesë të mbarë po edhe për ndonjë dhuratë).*

*T' ulumtë krahu (për ndonjë punë, për ndonjë shërbesë të mbarë po edhe për ndonjë dhuratë).*

*Paç dorën e mbarë (urim për nunin që vë kurorën).*

*Zënsht baltë e t' ubëftë flori në dorë, ar e ergjënt në dorë.*

*Emërin e gëzofsh (urim për festë emëri ndër të krishterët).*

*E paç shumë vjet emërin.*

*E paç për njëqind vjet emërin.*

*Trashëgofsh emërin (urim për festë emëri ndër të krishterët)*

*Rrofsh me emër (urim për festë emëri).*

*T' ulumtë goja (për ndonjë fjalë të mbarë).*

*Të pafshim të gëzuar.*

*Nga mot gëzuar (urim për festë; të përgjigjët është: të gjithë bashkë).*

*Krushqi e pandarë (urim ndër krushq).*

*Mirë se ju gjeta (të përgjigjët: të gjetë e mira).*

*Me këmbë të mbarë (për të lindur).*  
*T' ulumshin këmbët (që na nderove dhe erdhe).*  
*T' ubëftë këmbë flori, ar e ergjënt.*  
*T' u rrittë nderi.*  
*Qofsh rrofsh me nder.*  
*Mbifsh mbi gur të thatë (për bimët kur i mbjelliinj).*  
*Ju (u) dëgjofshim të mirën (të përgjigjët: Të mirë paç).*  
*Mot më mirë me ç'ju do zemra (urim për festë; të përgjigjët: të gjithë bashkë).*  
*Të paçim sa malet.*  
*Pleqëri e mbarë, e mirë (urim për pleqt' e plakat).*  
*Me poganik djali (mashkulli) (urim për ndonjë që s'ka pasur fëmijë mashkull).*  
*Me poganique (për ata që s'kanë pasur edhe po fëmijë).*  
*Ju rruat (urim për të lindur).*  
*Rrofsh e qofsh (të përgjigjët: të rruat kryet).*  
*Të rruatshin djemtë, fëmija etj.*  
*Gëzofshi të rijtë (për dhëndërr' e për nuse).*  
*Trashëgofshi të rijtë (për dhëndërr' e për nuse).*  
*Puna e mbarë (urim mbë të punuar; të përgjegjëtë: mbarë paç).*  
*Mbetshi me shëndet (të përgjegjëtë: shëndet paç).*  
*Rri me shëndet.*  
*Fal me shëndet.*  
*Vafsh e ardhsh shëndoshë (urim për njeri që niset për rrugë të gjatë; të përgjegjëtë: të gjeça shëndoshë).*  
*Upjekshim shëndoshë, me shnëndet (të përgjegjëtë: shëndet të kesh, paç).*  
*Ju (u) qoftë ndihmë (urim për festë).*  
*Për shumë vjet, mote (urim për festë, të përgjegjëtë: të gjithë bashkë).*  
*Me trashëgim (urim për të mbluar, për fejesë dhe për martesë).*  
*Utrashëgoftë.*

*Utrashëgofshin të dy palët.*

*U trashëgofshin e uplakshin.*

*Udha e mbarë (të përgjegjëtë: mbarë paç).*

## MALLKIMET

Hartuesi i Fjalorthit ka bërë një punë me të vërtetë të admirueshme ashtu si edhe te urimet për vjeljen e regjistrimin me përkushtim të një lagjeje relativisht të madhesh mallkimesh (rreth 200 të tilla). Këto lloj shprehjesh popullore në botën shqiptare janë shumë – shumë të pranishme (nuk kanë numër në shqipe, thotë P. Tase, - pra janë të panumërta). Asnjë lloj ligjërimi nuk mund të jetë asnjëherë ndaj tyre. Etnologët shqiptarë kanë mbi tavolinë një material kaq të pasur për t'u interpretuar e për t'u shpjeguar. Besojmë se përballja qindrashekullore me vështirësitë e jetës, me kushtet e ashpra natyrore, me armiq të panumërt historikë, me mungesën e një emancipimi të gjithanshëm, apo edhe me elementet e kulturës pagane, kanë qenë ndër shkaqet kryesore se përse populli i krahinave të Përmetit, por edhe i gjithë Shqipërisë ka krijuar kaq shumë mallkime. Nëse i krahasojmë numerikisht ato me urimet, na del se mallkimet janë tri herë më të shumta se urimet. Ne po i japim të plotë nga Fjalorthi i ri i Pano Tases zërin ***mallkime***:

***Mallkime** (Shënim: Gjindja e jonë i druan tepër mallkimet dhe mundofta ky është shkaku që mallkimet e namatimet nuk kanë numër në shqipet. Që këtu një pjesë e atyre që përdorin gratë të rrethit të Përmetit, për më të shumët të cilëvet nuk u pa nevoja të shtohet përbrinjë të tfillurit, mbas si kupëtohen vehtiut):*

*Eja mos ardhsh i gjallë.*

*Erdhe të ardhhtë guna, shif: gunë.*

*Të rafshin ardhjet, ty ardhjemath, shif: ardhje.*

*T'ushtyfishin ardhjet në grykë, shif: ardhje.*

*Mos e ngoptë barkun me bukë kurrë.*

*Të vraftë buka.*



*Të zëntë sytë buka.*  
*Të lëntë pa sy buka.*  
*Të plastë buza, ty buzëplasur.*  
*Mos të qeshtë buza ty buzë-pa-qeshur.*  
*Mos të raftë në barkut, në bark, në barkun – mos e ngjirofsh, mos harrifsh t' e hash, mos të vaftë në bark.*  
*Mos ubëfsh të bëhesh.*  
*Mos harrifsh të bënesh.*  
*Të lidhsha buzën, buzët – të pafsha të vdekur, vdeksh dhe qofsha unë për të lidhur buzën.*  
*T' ulidhtë buza e mos t' uzgjidhtë kurrë – mbeç pa gojë.*  
*U nxiftë ay bark që të ka mbajtur.*  
*Të dhënsha barin e mishit – barin e mijve, helmin, zernikun.*  
*Të dhënsha barin e sorrës.*  
*Barku të roftë (të rroftë, të gërryestë).*  
*Bretku të roftë (të rroftë, të gërryestë, të griftë zorrët).*  
*Mos u hëngërt të hahet (dhe ajo buka jote.*  
*Bisha të rëntë dhe të ngrëntë.*  
*Të zëntë cërma.*  
*Rri të ndënjtë çepja (namatim poshtërimi). (shënim: në këtë kupëtim afëro thonë dhe: Rri të ndënjtë thika në mushkëri. Çepja të jetë vallë baras me çepele, thikë?).*  
*T' ukyçtë, t' umbylltë dera ty derëzi, ty derëmbyllur, ty derëherët.*  
*Ditë të mirë mos pafsh.*  
*Mos të zëntë darka.*  
*Mos të zëntë dita e nesërme kur të vinj.*  
*U nxiftë ajo ditë që ke le.*  
*Upërmbystë djepi që të ka tundur.*  
*Ditëzi – ditëerrët; - e ditëshkurtër.*  
*T' unxiftë dita.*  
*T' ushkurtoftë dita; - t' ushkurtofshin ditët.*

*Ditë të bardhë mos pafsh; mos pafshë ditë të bardhë.*  
*Mos të dashtë Perëndia.*  
*T' uthafshin duartë.*  
*Mos të qeshtë dhëmbi.*  
*Të zëntë në dhe (në gropë) moti kur të vinjë.*  
*Të hëngërt dheu; - Të hëngërt balta.*  
*Të ngriftë dhjamët e mos të shkrihtë (e mos t' ushkrihtë).*  
*Ju (u) hëngërt dhelpira (për pulat).*  
*Ec e mos vafsh i gjallë.*  
*Ec mos harrifsh të veç.*  
*T' u shoftë emëri; - T' ushoftë e t' uharroftë emëri.*  
*Mos t' undiftë më emëri.*  
*Të plastë t' ëmbëlit.*  
*T' uzëntë fryma ty frymëzënë.*  
*Mbetsh pa frymë ti frymëzënë.*  
*Mos mbetët frymë nga juve (nga ju; jush; për gjë të gjallë, për kafshë,  
 për shpezë).*  
*Mos ugdhifsh i gjallë.*  
*T' umarrtë goja; -T' uzëntë goja.*  
*Mbetsh pa gojë.*  
*Të marrtë perëndija gojën.*  
*Të lëntë perëndija pa gojë.*  
*Të hëngërsha grurët (që ndajnë të krishterët për të vdekur).*  
*T' uthaftë goja; T' uthaftë gjuha.*  
*Të rënëshin grykët ty grykërenë.*  
*Të zëntë gjuhën një qime e gjatë.*  
*Mos ugëdhifsh të gëdhiesh për nesër.*  
*E gjetsh nga perëndija.*  
*E gjetsh nga mos e pandefsh.*  
*T' uderdhtë gjaku e të vafhtë çurkë.*  
*Të zëntë gjarpëri duartë.*

*Mos mbetsh i gjallë.*  
*T' uthaftë gjuha e t' u këputë gjer në rrëzë.*  
*Të raftë gjuha copë.*  
*Flejtsh të madhin – fjetsh gjumin e vdekjes.*  
*Folsh e lidhsh gjuhën (gojën).*  
*Ju (u) hëngërt gjeraqina (për pulat).*  
*Kafshofsh gjuhën.*  
*Kafshije të kafshuarën (gjuhën) – hesht; mos fol.*  
*Humbsh e mos uduksh.*  
*Mos të zëntë java.*  
*Mos e shpufsh kokën*  
*E solli kokën që mos e sjelltë.*  
*Të plastë koka.*  
*T' utheftë koka.*  
*Mos i rafsh këmbës, shif: këmbë.*  
*Më marsh të keqen.*  
*Më marsh të keqen e qenit.*  
*T' ushpiktë të keqtë.*  
*T' ushpiktë koq' e mirë në grykë.*  
*Të raftë i sipërmi në kokë.*  
*Të zëntë kolonica (koloneci).*  
*T' uthaftë koka.*  
*T' uthafshin këmbët.*  
*T' thaftë çaçk' e kokës.*  
*Hëngërsh kokën; - hëngërsh këmbët.*  
*Mos mbetët këmbë për gjalmë (për pulat).*  
*Udjegsh lugat (luegat).*  
*Më marsh të ligat.*  
*T' uzëntë lyfyti.*  
*Mos të zëntë moti kur të vinjë.*  
*Të marrtë Perëndija mëndjen.*

*Të lëntë Perëndija pa mënt e marsh malet e shkëmbënjtë.*  
*Të rafshin mishrat në dhe; - Të rafshin mishërat copë.*  
*Uënjtësh e ubëfsh mal.*  
*Mos e zëntë e nesërmeja.*  
*E ngaftë e ngara; e zëntë ajo e tokës.*  
*Mos e ngjërofsh; - mos e pshymsh.*  
*Të raftë pika e të pikoftë ty pikë rënë.*  
*Thefsh parmën.*  
*Më marsh pleshtat.*  
*Të zëntë piseri; Të zëntë piseri duartë (piser, ri ?).*  
*Ubëfsh ponogom, shif: ponogom.*  
*Mos e dëgjofsh qyqen kur të këndonjë – vdeksh, mos të zëntë vera.*  
*Mos e gëzofsh të ritë.*  
*Të vraftë rufeja (rrufeja).*  
*Mos urrotullofsh të rrotullohesh – mos ukëthefsh të këthehesh; mos e sjellsh kokën; mos ardh i gjallë në shtëpi.*  
*Të rëntë një koqe rrufe e të rrufepsët (e të lëntë në vënt).*  
*Të plaçin sytë e të dalshin dhe i mbajtsh në pëllëmbë.*  
*Mbettë pa sy.*  
*I dalshin sytë.*  
*Të nxjertë korbi sytë; - të lëntë korbi pa sy.*  
*I raftë skundra e e skundëroftë (Shënim: skundra është një sëmundje që u bije pulave).*  
*Mos e zëntë e sormja (dita e sorme).*  
*Shko e shporru këtej.*  
*Shko e mbytu; - Shko e nxir sytë.*  
*Të ngaftë shkuma (një shkumë) e të shkumëzofhtë ty shkumëngarë.*  
*Ushurdhofsh nga veshët.*  
*Të raftë shapllamaj ty shapllamath (shapllama?)*  
*Ju hëngërt shqipja dhe ju shqipoftë (mallkim për pulat).*  
*Të dalshin trutë.*

*Të zëntë tartakuti.*

*Të rëntë tartakuti tartakutmath.*

*Uënjtësh ubëfsh trokaxhik (fjalë e huaj; shqip kacek).*

*Rri të ndënjtë thika në mushkëri.*

*Ju (u) çaftë ujku (mallkim për gjënë e gjallë).*

*Ujku të hëngërt' e mos të lëntë të gjallën. (mallkimpër kafshët).*

*Të çaftë një ujk e të bëftë magje (mallkim për kafshët).*

*Vraj (vrafsh) vehten (mu) në gjumë.*

*T' uvidhistë koska e t' utrapistë ty varrëvidhisur.*

*Uvidhissh e utrapissh ti varrëvidhisur.*

*Të plastë vreri.*

*Të vraftë larashi (kal' i qyqes) (Shënim: mallëkim përçëmimi dhe të poshtëruari, për të tregaur se s'je i zoti të pruaqsh vehten as nga larashi, as nga kali i qyqes).*

*Të vraftë qulli (mallëkim poshtërimi dhe të përçëmuari; që s'e vëjen as qullin që han).*

*Humbsh si vesa.*

*Të humbtë vula.*

*Mos i vafsh shtëpisë.*

*Mos harrifsh të veç i gjallë (në shtëpi) po të shpufshin zigarezaj – të shpufshin katër (Shënim: zigarezaj, ndofta fjalë e huaj).*

*Të rrafshin valat e limit (të detit).*

*Utërbofsh e marsh malet.*

*Vafsh e mos ardhsh i gjallë.*

*Martë dhe mos pastë, me ato mbetë - (mallëkim për ndonjë të vjedhur, kur nuk dihet dorasi, ose kur vjedhësi është njeri me cen dhe të kallëzuar të të dënuarët të tij munt të sjellë mbë krye cenë dhe dëme të mëdha).*

*Të hëngërtë xalja (xalja?).*

1. Nëse mund të bëjmë një klasifikim sipas aktit të komunikimit<sup>30</sup>, sipas situatës ligjërimore të përfytyruar ku ndodh shkëmbimi i mesazhit midis dhënësit e marrësit, te mallkimet që sapo përmendëm, por edhe te dhjetëra e qindra të tjera, dallojmë katër grupe kryesore

a. Dhënësi i mesazhit (emetuesi i mallkimit) është një njeri – grua dhe marrësi (atij që i drejtohet namatimi, mallkimi) është po një njeri, tashmë pa dallim moshe e seksi. Këto përbëjnë grupin më të madh paradigmatic të këtyre shprehjeve popullore.

b. Dhënësi i mesazhit (emetuesi i mallkimit) është një njeri – grua dhe marrësi (atij që i drejtohet namatimi, mallkimi) është një kafshë që animizohet, që personifikohet dhe duket sikur e dëgjon nëmën. Ky numër është i vogël, sepse në përgjithësi edhe lloji i kafshëve që mbarështoheshin a mbarështohen në shtëpi është i vogël (numri i tyre mund të jetë relativisht edhe i madh).

c. Dhënësi i mesazhit (emetuesi i mallkimit) është një njeri – grua dhe marrësi (atij që i drejtohet namatimi, mallkimi) është një shpend shtëpiak, por edhe i egër. Edhe këtu marrësi i mesazhit personifikohet.

d. dhënësi i mesazhit (emetuesi i mallkimit) është një njeri – grua dhe marrësi (atij që i drejtohet namatimi, mallkimi) është një send, zakonisht një mjet pune a një orendi shtëpiake që mund të dëmtohet etj. Prandaj edhe asaj i drejtohet nëma, por përsëri duke e nënkuptuar zakonisht si qenie të gjallë, duke e personifikuar ashtu si ndodh edhe me grupet e mësipërme.

Pano Tase ka meritën tjetër se në faqet e Fjalorthit të ri ai jo vetëm pasqyron shumë mallkime, por ato i shoqëron edhe me kompozita dëshirore gjegjëse. Kjo nuk ka vlerë thjesht dokumentimi, por tregon edhe procesin e ngjizjes së kompozitës si dhe tregon mundësitë e pafundme të gjuhës shqipe për të formuar njësi të tilla kaq të bukura, edhe pse nga përmbajtja dhe psikologjia mund të jenë drithëruese P.sh. *T' uzëntë fryma ty frymëzënë; T' ukyçtë, t' umbylltë dera ty derëzi, ty derëmbyllur, ty derëherët; Të rafshin ardhjet, ty ardhjemath; Të ngaftë shkuma (një shkumë) e të shkumëzoftë ty shkumëngarë etj.*

---

<sup>30</sup> Gj. Shkurtaç, Sociolinguistika, Tiranë 1999, f. 119- 120

2. Me interes është për rrafshin e përmbajtjes edhe modaliteti i foljeve që mbajnë peshën kryesore në namatime a në mallkime. Sintaksorisht këto ndërtime përfshihen te fjalitë dëshirore, tek të cilat dëshira mund të jetë dy llojshe: në formë urimi dhe në formë mallkimi<sup>31</sup>.

3. Në *Fjalorthin e ri* mund të ndjekim edhe një dukuri të rrafshit diakronik, edhe pse lënda e pasqyruar në të tregon gjendje gjuhësore (rrafshi sinkronik) dhe jo zhvillim gjuhësor, mund të ndjekim kalimet nga mallkimi në betim: ***Mos ardhsh (i) gjallë! (mallk.) / mos ardhsha (i/e) gjallë! (bet.); Të zëntë buka sytë! (mallk.) / Më zëntë buka sytë! (bet.)*** etj.

E rëndësishme është se këtu ndodh një dukuri interesante. Akti i komunikimit në rastin e mallkimeve e bën bashkëbiseduesin a bashkëbiseduesit objekt a pasues potencial një fatkeqësie etj., d.m.th., dhënësi e adreson drejtpërdrejt mesazhin dëshiror të marrësi (***Mos e pafsh dritën e diellit!***). Kurse në rastin e betimit, dhënësi shfaqet vetë si objekt a si pasues i një fatkeqësie etj. (***Më zëntë buka sytë!***) etj.

4. Interesante të shprehjet popullore veçanërisht të ato në formën e mallkimeve është edhe sintagmatika e tyre. Përgjithësisht ato janë përdorime gati të gatshme të *sintagmave – fjali*. Jo rrallë në *Fjalorth* ne hasim përdorime dyshe: mallkime të plota, por edhe mallkime të gjymta, që kuptimisht janë të barasvlershme me ato të plota. P.sh., ***Të rëntë një damlla e madhe, o damllamath!*** apo ***Të rëntë damllaja, o damllarënë!*** dhe ***Damllaja, o damllamath*** apo ***Damllaja, o damllarënë!*** Këtu, përmes mishërimit të ligjit të ekonomisë gjuhësore (sidomos në ligjërimin gojor, ku janë të pranishme edhe mjetet paralinguistike) ndodh jo vetëm rrudhja e gjymtyrëve, por edhe dukuria e kondesimi kuptimor. Veç këtij kondesimi kuptimor<sup>32</sup>, si shihet në shembujt e dhënë, dalëngadalë lindin fjalët e përbëra, duke mënjanuar valencat e jashtme kuptimore e sintaksore dhe duke shpërfaqur valencat e brendshme. Në këtë

---

<sup>31</sup> Gramatika e gjuhës shqipe, 2, Tiranë, 2002, f.

<sup>32</sup> J. Thomai pranon se “Kondesimi kuptimor është një rregullsi... edhe gjatë formimit të fjalëve”. Shih J. Thomai, Prejardhja semantike në gjuhën shqipe, Tiranë, 1989, f. 315

mënyrë shumë mallkime dalin të shprehura në tri forma, si thënie - mallkim i plotë, si thënie – mallkim i gjymtë a i rrudhur dhe si fjalë e përbërë (si kompozita dëshirore<sup>33</sup>).

Edhe në këtë rast kompozitat janë ekzocentrike, pavarësisht se janë dëshirore. Ato ose do të krijohen nga një emër dhe një mbiemër që shfaqen në përdorimin e dhënë sintagmatik (shih **damllamadh**) ose do të krijohen nga një emër dhe mbiemri prejpesor i ndërtuar në çast nga folja që shpreh dëshirën në formën e mallkimit në thënie (shih **damllarënë**). Mbiemrat këtu nuk janë në funksion atributiv edhe pse janë atribut i gjymtyrës nga varen. Ata janë pjesë e gjithë kompozitës që shënon një tipar jashtë vetvetes, prandaj quhen edhe ekzocentrike. **Damllamadh** nuk do të thotë **damlla e madhe**, por emërtohet dikush të cilit i dëshirohet një fatkeqësi, t'i bjerë një damlla e madhe. Kështu ne gjejmë lehtësisht: *Të rëntë një damlla e madhe, o damllamadh!* dhe *Të rëntë damllaja, o damllarënë!*; *Të rëntë një pikë e madhe, o pikëmadh!* dhe *Të rëntë një pikë, o pikërenë!* etj. Këto kompozita në thënie të tilla shfaqen në përdorim dhe kuptimisht si emra, pavarësisht se modeli fjalëformues fillimisht mund të jetë për mbiemra ekzocentrikë.

## BETIMET

Përmetari, ashtu si shqiptarët gjithandej vendit, në mungesë të shtetit dhe të ligjeve e të ligjshmërisë, për të organizuar jetën vetiake, familjare, shoqërore, shtetërore etj., ka krijuar elemente të konstitucionit të pashkruar. Ndër to do të veçojmë **betimet**, që mund të lidhen me gjithanshmërinë e jetës së tij. Autori i Fjalorit nuk i ka anashkaluar edhe këto formula komunikimi, të ngjeshura semantikisht në skajshmëri. Mbase numri i tyre nuk është shumë i madh (janë mbi 30), por ato shpërfaqin vlera të kulturës e të etnosit, ashtu si shpërfqin vlera gjuhësore (sidomos semantike, sintaksore, stilistikore etj.):

---

<sup>33</sup> A. Kostallari, Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes, në “*Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe*”, 1, Tiranë, 1972, f.



*Për këtë bukë.*  
*Buka më zëntë sytë.*  
*Për atë bukë që na mban me frymë.*  
*Më vraftë buka që ha.*  
*Për këtë baltë që do të nahajë (tuke përpyetur këmbën për tokë*  
*Për ç'besojm ti dhe unë bashkë.*  
*Për këtë dhe që na ushqen e na mban gjallë.*  
*Për kokën e djalit të vetëm që mezi e kam.*  
*Për këtë gur (tuke zënë gurin me dorë).*  
*Për kokën e djemëvet (etj.).*  
*Për kokën t'ime.*  
*Për kokën t'ime që s'ma bën më nëneja.*  
*Për atë kishë (tuke diktuar një kishë aty afër).*  
*Për këtë kishë (tuke i rënë me pëllëmbë murit të qishës, kur janë puqë*  
*metë).*  
*Për atë kungim.*  
*Për këtë kryq.*  
*Për zonë Krisht.*  
*Për këtë nur (fjalë tyrqishte) që po digjet aty (tuke diktuar dritën e*  
*ndezur).*  
*Për këtë qiri (tuke ndezur e shuar një qiri në qishë).*  
*Për synë e djellit.*  
*Për sytë të ballit.*  
*Mbetësja pa sy (tuke zënë sytë me dorë).*  
*Mbetësja pa sy dhe lypësja derë më derë.*  
*Për shpirtin e atyre që po treten atje (tuke diktuar varre).*  
*Për atë ungjill.*  
*Mbetësja i verbërë (tuke zënë sytë me dorë).*  
*Për zotin.*  
*Për Zon' e vërtetë.*  
*Për këtë zjarr (tuke diktuar zjarrin).*

## NGUSHËLLIMET

Fjala *ngushëllim* në FGJSSH (1980) ka tri kuptime. Kuptimi që na intereson ne në lidhje me pasurinë që kemi zbuluar në *Fjalorthin e ri* është: “*kryes. sh.* Fjalët dhe ndjenjat që shprehim për të ngushëlluar dikë kur i vdes një i afërm.”

Të ngushëllosh do të thotë që të përpiqesh t’i lehtësosh dhembjen a hidhërimin dikujt duke i dhënë zemër me fjalë të mira, t’i japësh zemër dikujt për të përballuar një fatkeqësi. Populli ynë në rrjedhë të shekujve nga gjithë situatat ligjërimore që lidhen me këtë proces, ka krijuar formula të gatshme që përbëjnë një pasuri etnogjuhësore të vlerësueshme. Të tilla shprehje – formula i kemi, si thamë, edhe në *Fjalorth*. Numri i tyre është vetëm 15, por vlera e tyre e shumëfishtë shfaqet ashtu si edhe për mallkimet, urimet, betimet etj.

### *Ngushëllime:*

*(Shënim: Si për urime ashtu edhe për ngushëllime gjindja e jonë ka shumë mënyra të thëni; këtu pas po shtrojmë disa të thëna për ngushëllim, që përdoren sidomos në qolli vdekje).*

*Urdhëri (emëri; tyrq.) i Zotit, i Perëndisë.*

*Punëra të Perëndisë.*

*Ashtu, kështu qe thënë prej Zotit.*

*S’i dalim dot përpara Perëndisë.*

*Ndij-e zot shpirtin e tij (e saj).*

*Zoti, Perëndija e ndjeftë.*

*Zoti, Perëndija vëntë dorë në t’jerët.*

*Të rroni vetë.*

*Të rrojnë të tjerët.*

*Zotëria e juaj shëndoshë.*

*Ndjesë pastë.*

*I ndritë shpirti ku ka rënë.*

*Ashtu, kështu, qe shkruar.*

*Për gas e në (për të) mira u mbledhshim (kur rrijnë në mësallë).*

*Për gas (të përgjegjurit: Gas e të mira paç).*

Po të ndalemi në rrafshin e përmbajtjes së këtyre formulave ngushëlluese vërejmë dy dukuri: e para është gjuhësore që ka të bëjë me të ngushëlluarit si veprim dhe si shprehje gjuhësore. E dyta është etnografike, sociale, psikologjike etj. Kështu në shtatë të parat e njësisve të mësipërme (nga dhjetëra e dhjetëra të tjera që nuk janë pasqyruar në Fjalorth, por që ekzistojnë në gojën e popullit) kemi elementin fatalist: që person erdhi në kët jetë dhe iku, se e mori Perëndia. Njeriu përballë vdekjes është i pafuqishëm, duhet ta pranojë atë si vjen dhe, sipas këtyre ngushëllimeve, e vetmja gjë që duhet të bëjë ai që pret ngushëllimin, është që t'i kthejë sytë nga Perëndia dhe të vazhdojë jetën me njerëzit e tjerë dhe me punë.

Te ngushëllimet duhet të dallojmë ndër të tjera dy dukuri (që mund të vështrohen edhe nga modaliteti i foljeve etj):

a. Shumë ngushëllime jo vetëm kërkojnë të lehtësojnë dhimbjen për fatkeqësinë, por shprehin edhe një dëshirë në formë urimi: *Zoti (Perëndija) vëntë dorë mbi të tjerë. Të rroni vetë. Të rrojnë të tjerët. Zotëria e juaj shëndoshë. Ndjesë pastë. I ndritë shpirti ku ka rënë* etj.

b. Shumë formula karakterizohen nga asnjënjësia (neutraliteti) i të shprehurit: *Punërat e Perëndisë. Kështu ishte shkruar* etj.

## C. VEÇORI TË NDËRTIMIT SINTAGMATIK TË SHPREHJEVE POPULLORE

Nëse shprehjet popullore i vështrojmë nga ana ndërtimore (sintagmatike) do të gjejmë shumë strukura interesante. Megjithatë ato mund të përshihen në dy grupe të mëdha:

a. *Ndërtime të plota a përdorime fjalish: Ashtu, kështu që thënë prej Zotit. S'i dalim dot përpara Perëndisë. Të lidhsha buzën, buzët – të pafsha të vdekur, vdeksh dhe qofsha unë për të lidhur buzën etj.*

Folja e ndërtimeve shpesh është e përcaktuar nga natyra shprehjeve (e përshëndetjeve, e urimeve, e mallkimeve, e ngushëllimeve, e betimeve etj.). Kjo kërkon një punim të mirëfilltë dhe shumë të gjerë, të cilin mund ta ndërmarrim në të ardhmen. Por shkarazi mund të themi se mbizotërojnë foljet në dëshirore, në lidhore, duke mos munguar ato të mënyrës dëftore.

Brenda këtij grupimi mund të bëjmë nëngrupime të kushtëzuara semantikisht a strukturalisht. Mund të kemi shprehje popullore sidomos urime e mallkime që mund të jenë fjali me një folje ose me një lidhje kallësuesie, por edhe shprehje me dy folje a me dy lidhje kallëzuesie. Në rastin e dytë folja e mënyrës dëshirore e lidhore mund të rimerret për të intesifikuar, për të përshkallëzuar intesitetin e dëshirës.

- Nëse fjalitë janë *asidentike* ky intesitet është shumë i lartë dhe atëherë mallkimi / urimi janë skajor. P.sh., *Mos ubëfsh të bëhesh. Mos harrifsh të bënesh etj.*

- Nëse fjalitë janë sidentike, ky intesitet e përshkallëzimi i tij janë më të ulët, më të zbutur, dëshira edhe pse e fuqishme, nuk e ka forcën e mallkimeve / të urimeve të grupit të mësipërm. P.sh., *T' ulidhtë buza e mos t' uzgjidhtë kurrë etj.*

- Interesante janë edhe disa mallkime (por edhe urime) që ndërtohen me dy folje antonimike, të cilat bëhen shprehëse të përshkallëzimit të dëshirës dhe të rritjes së intesitetit: *Të ngriftë dhjamët e mos të shkrihtë (e mos t' ushkrihtë). T' ulidhtë buza e mos t' uzgjidhtë kurrë etj.*

b. *Ndërtime të tkurrura, të rrudhosura, të paplota*, të cilat për së shumti kanë përfunduar *në ndërtime nominative togfjalëshore*. Kjo bie në sy sidomos në përshtendjet dhe në betimet, por nuk të mos i gësh edhe te llojet e tjera të shprehjeve popullore të pasqyruara në fjalor: *Për këtë bukë. Për këtë gur (tuke zënë gurin me dorë). Për kokën e djemëvet (etj.).Për kokën t'ime. Për atë kishë (tuke diktuar një kishë aty afër).Për këtë kishë (tuke i rënë me pëllëmbë murit të qishës, kur janë puqë metë). Për atë kungim. Për këtë kryq. Për zonë Krisht. Për këtë nur. Për këtë qiri. Për synë e djellit. Për sytë të ballit. Urdhëri i Zotit, i Perëndisë. Punëra të Perëndisë etj.*

## KREU V

### RRETH PASURISË SEMANTIKE TË “FJALORTHIT I RI”

#### A. VEÇORI ONOMASIOLOGJIKE

*Fjalorthi i ri* siç jemi shprehur është fjalor shpjegues. Dhe pasuria e tij së pari duhet të vlerësohet në rrafshin onomasiologjik, se si shprehen gjuhësisht nocionet për sende, frymorë apo për dukuri abstrakte. Në përgjithësi kemi një punë të mirë, edhe pse P. Tase nuk është as gjuhëtar, as leksikolog e leksikograf.

Fjalori si jemi shprehur ka rreth 2000 njësi fjalë dhe njësi frazeologjike e shprehje popullore. Ato që konceptuar nga autori si njësi dialektore janë shpjeguar zakonisht me perifrazim dhe shumë dendur edhe me sinonimi (madje me vargje sinonimike), me njësi që njihen nga shqipfolësit jashtë mjedisit përmetar. Gjithashtu, meqenëse shumë njësi janë terma nga fusha të ndryshme, njësitë shfaqen njëkuptimshe (monosemantike). Nisur nga ky këndvështrim, bie lehtësisht në sy që në vepër mungon gati në skaj dukuria e polisemisë, mungon antonimia, si dhe homonimia. Nga pozita e kërkuesit dhe nga përvoja e ditëve të sotme (kur kemi arritje të mëdha në leksikografi, krahas, studimeve në leksikologji e në semantikë), mund të pohojmë se polisemia mund të gjurmohet në shumë struktura kuptimore fjalësh, sidomos kur jepen thënie që mund të shfaqen si kuptime të njëjës a të tjetrës njësi leksikore.

## KREU V

### VEÇORI MORFO-STRUKTURE E FJALËFORMUESE TË LEKSIKUT TË FJALORIT

Nga ana morfo-strukturore pasurinë leksikore të fjalorit e ndajmë në dy grupe të mëdha: **në emërtime të thjeshta** ( njëfjalëshe) dhe **në emërtime të pathjeshta** (emërtime togfjalësha).

#### EMËRTIME TË THJESHTA

Emërtimet e thjeshta, formojnë grupin kryesor të fjalëve në vepër. Ato i kemi ndarë në dy grupe të mëdha: në fjalë të parme dhe në fjalë jo të parme.

**a. Fjalët e parme** mund të jenë pjesë të ndryshme ligjërata, si **emra**: *lumë, lugë, lopë, qer, hundë, dele, bisht, thump, çok, bujgër, kërr, luk (gu)* etj.; folje: *lip, qelb, mbiemra, ndajfolje, parafjalë, përemra* etj.

**b. Fjalë jo të parme** formojnë grupin më të madh të fjalëve. Ato janë mbi 1000 njësi. Më poshtë po japim tipat kryesorë dhe mënyrat më të njohura të fjalëformimit për këto fjalë.

#### *Fjalë me prejardhje*

Fjalori i Pano Tases u botua në vitin 1941, në një kohë kur u botua edhe Fjalorthi i ri i N. Gazullit. Por Gazulli jo vetëm që në jep një vepër më të plotë, më të arrirë nga të gjitha anët, por në pjesën e parë ai na jep edhe mjetet kryesore të fjalëformimit me prejardhje në gjuhën shqipe (me rreth 25 faqe)<sup>34</sup>. Ndiheja e tij tani pranohet nga gramatikanë edhe studiues të fushave të tjera. Kurse te Fjalori i Tases nuk e kemi këtë lloj paraqitje e këtë lloj punimi. Ne po i zbulojmë vetë këto mjete fjalëformues duke u ndalur sidomos në parashtesa dhe prapashtesat kryesore.

---

<sup>34</sup> N. Gazulli, Fjalorth i ri, Tiranë, 2005, f. 17 - 41

### a. Fjalë të formuara me parashtesim

Formimet me parashtesa janë të pakta, nëse i krahasojmë me grupin paradigmatic të njësive të formuara me prapashtesa:

*ç-: çënjtrem, çqep, çkoleps,*

*m-: mblatës, mbletë, mëkonj, mpshonj,*

*për-: përbisht; përlëfytem; përmënoj,*

*sh-: shvishem; shthotë,*

*shpër-: shpërkëndoj etj.*

### b. Fjalë të formuara me prapashtesim

Po japim disa nga prapashtesat kryesore që menduam të veçojmë dhe, për ilustrim, edhe disa fjalë ku ato shfaqen:

*-ak: kotherak*

*-an: bukuran, verdhan, vockaran*

*-ash: balash, gjumash*

*-ar: pasunar, cergar,*

*-ezë: bishtezë;*

*-ës: dredhës, kamës, mbatës, petës,*

*-zë: bushtëzë, dredhëzë, grykzë,*

*-im: nxihirim, përtim, mallkim, namatim,*

*-je: anëje, barkje, dorje, këputje,*

*-(i)sht(e): gardhishte, thjerishte, gurishte; ëngjirishte,*

*-më: cingërimë, vidhismë, ulurimë,*

*-kë: breskë, sitkë, syskë, shoshkë,*

*-në: bokërinë, alurinë, farurinë,*

*-ore: dimërore, gardhore, shtratore,*

*-të: i dhirtë, i gorictë, i mektë etj.*

### *Fjalë të përbëra*

Sipas A. Kostallarit, fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në shqipen është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy ose më



shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintatike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramtikore të komponentëve të saj<sup>35</sup>. Në fjalor gjejmë shumë kompozita sidomos me vlerë mbiemërore, duke iu shfaqur së pari si kompozita ekzocentrike. Nuk mungojnë edhe llojet e tjera. Psh: *buzëmadh, buzëvartur, buzëtorroveckë, turilëshuar; buzëlëshuar, turivrënjtur, fytyrëvrënjtur, faqekuqë, faqeshegë, faqerroshë, shkreto-shtëpi, gojëbirbil, gojëmbërthyer, gojëprishur, gojëzënë; gjuhëshpejtë, gojëshpejtë, gushë dalë, gushëkuqës, gushmakuqës, meskëputur, mëndjeerrët, mëndjemadh, mëndjezi;*

Autori na sjell shumë kompozita dëshirore<sup>36</sup>, krahas atyre determinative ekzocentrike, si p.sh.:

**Ditëshkurtër (-ri):** § (si mallkim) që është më mirë të mos jet' i gjallë; t'i shkurtohen ditët; të vdesi.

**Dorëkëputur (-ri)** (si namatim) që e vejën t'i këputet dora, krahu. Shif: dorëtharë. Sh.: pse më rrahe djalin more dorëtharë e dorëkëputur. Më rrahu djalin ay dorëkëputuri që i ukëputtë gjer në rrëzë.

**Gojëmbërthyer (-ri):** ujku, i pagoji, bisha e pagojë. § i mbërthyer goja, i lidhur goja, i mbyllur goja. Sh.: e mbërtheu gojën gojëmbërthyeri, e mbylli gojën, gojëmbylluri.

**Qafëkëputur (-ri):** Sh.: e këputi qafën ai qafëkëputuri – ushporr; na uhoq qafet (si mallkim) si namatim për ndonjë njeri të mërxitur, për ndonjë njeri të lik; që nuk na pëlqen t'a kemi pranë).

**Qafëthyer (-ri):** Sh.: erdhi ay qafëthyeri që mos e pruftë kokën – (si mallkim, si namatim për ndonjë veht që nuk duam t'i shohim sytë).

<sup>35</sup> A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe në Studime mbi leksikon e formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 1, Tiranë, 1972)

<sup>36</sup> A. Kostallari, Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes në Studime mbi leksikon e formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 1, Tiranë, 1972

**Qafëzi** (-ziu; fem.: qafëzezë): një si : qafëthyer, qafëkëputur.

Edhe pse nuk është leksikolog, siç e kemi thënë shpesh herë në faqet e këtij punimi, hartuesi i Fjalorit me intuitë **jep ambivalencat e këtyre kompozitave interesante të shqipes, edhe si pronësore ekzocentrike, edhe si dëshirore**. Gjithmonë dukë mënjanuar kuptimet e drejtpërdrejta ai zbulon e qëmton me zgjuarsia kuptimet figurative:

**Dorëtharë** (-ri): i kursyer; dorështrënguar. § i pazoti për punë; që nuk i zë dora punë. § që prish në vënt që të ndreqnjë. (si namatim) që e vëjen t'i thahet dora, krahu. Shif: dorëkëputur. pse më rrahe djalin more dorëtharë e dorëkëputur.

**Emërëshuar** (-ri): i shuar (i harruar) emëri; i vdekur. § (si mallkim) që e vëjen t'i fshihet emëri nga vivëll' e të gjallëve; i cili vëjen të shduket nga jeta. § ose që i ushoftë (që mos i udëgjoftë) emëri ndë të gjallët; që vdektë. Shih.: vulëhumbur.

**Gojëzënë** (-ni): i zënë i mbyllur goja. § (si mallkim) që i ka hije, që e vëjen t'i zihet, t'i mbyllet goja. Shif: grykëzënë.

**Varrtrapisur** (-ri): (si mallkim, si namatim) të cilit s'i ka mbetur as varri; që dhe varri iubë trap.

§ të cilit mos i mbetë as varri , që iubëftë trap varri. Shif: varrëvidhisurë.

**Varrvidhisur** (-ri): si mallkim, si namatim) të cilit nuk i duket as varri; që i uvidhistë edhe varri, u zhduktë, mos mbetë , mos mbet. Shif: varrtrapisur.

Interesante janë edhe disa formime shpesh ndajfoljore me zanoren lidhëse **-a-**, të tilla, si *shkopacingël; shkopacingëthi; cingula-pjekthi, pjekacingëthi* etj.

Jo një herë kemi rimarrë mendimin se lënda që pasqyrohet në *Fjalorthin e ri* jo vetëm ka vlera gjuhësore (leksikore, semantike a frazeologjike). Ajo ka edhe vlera shumë të mëdha etnografike. Kjo duket jo vetëm të shprehjet popullore e te njësitë frazeologjike, por dhe të këto kompozita dëshirore. Aty

kemi një semantikë shumë të ngjeshur dhe shpreh elemente të botës shpirtërore, të besimit, të paganizmit etj. që mund të shikohen edhe në rrafshin përshkrues dhe në atë historik.

### ***Fjalë të përngjitura***

Kemi gjetur edhe një numër të vogël fjalësh të përngjitura, si *këmbëmbë-krahës*, *na-më-na* (*sikur, thuaj se*), *ndajnatëherë* etj.

### ***Fjalë me paranyjëzim***

Një nga grupet paradigmatiche më interesante në *Fjalorithin e ri* është ai i mbiemrave prejppjesorë. Janë me dhjetëra për mos të thënë më shumë numri i këtyre mbiemrave, edhe pse nuk janë dhënë shpesh foljet gjegjëse. Nuk e dimë pse, studiuesi V. Memisha që është marrë me mbiemrat prejppjesorë në gjuhën shqipe, nuk e përmend fare në monografinë e vet këtë pasuri të madhe leksemash, duke i parë ata si një grup njësisish që e pasurojnë shumë fjalësin e shqipes dhe ndihmojnë në sistemimin dhe në plotësimin e vargjeve fjalëformuese të saj.<sup>37</sup>

*cëritur* (*i -*) (*vaj o gjalpë i djegur, i skuqur mbi zjarr*), *i djegur, i skuqur, i bërë* (*gorricë e bërë*), *i pjekur, i harrirë* (*i arrirë*), *i rreshkur* (*gorricë e rreshkur*), *i sgajtur, i plogur, i plogështuar, i zgajtur, i rënduar, i ngëthur, i bullciqur* (*fiq të bullciqur*); *i përbishtur, i shpërndarë; i shprishur; i përshkënditur, i leqendisur, i brengosur, i mërxitur, i helmuar, i leverisur, i grisur, i shvatur, i leckosur, i çjerrur* etj.

---

<sup>37</sup> V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejppjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999

## B. EMËRTIME TË PATHJESHTA

Emërtimet e pathjeshta janë me dhjetëra në Fjalorthin e ri. Ato formojnë një pasuri me vlera terminologjik, por edhe etnografike etj. Do të përmendnim këtu njësi të tilla, si *pulë bufkë, pulë e mbathur, pulë me brekë; dardhë bishtezë, dardhë bishtje; dardhë dimarake; dardhë elbëzë, dardhë gomar, dardhë martolle, bukë e huptë (bukë e uptë, e vjetër, e motuar), bukë e huptuar, bukë e mbryme (bukë e zënë me brumë, me farë), bukë e ndorëme (bukë misëri, e ngurtë dhe pa farë)* etj.

Të tërheq vëmendjen në grupin e emërtimeve të pathjeshta një paraqitje leksikografike interesante. Shumë prej tyre jepen dyshe: edhe si emërtime të pathjeshta, edhe si emërtime të thjeshta. Këto të fundit nuk kanë dalë nga përngjitja e sintagmës apo nga kompozimi i modelit togfjalëshor, por gjymtyra e dytë e kompozitës është mëvetësuar si njësi emërtuese e drejtpërdrejtë. Filimisht kjo gjymtyrë, në përbërje të emërtimit të pathjeshtë, ka qenë me funksion artitativ. Tani ajo nënkupton edhe klasën e llojin ku bën pjesë sendi a frymori që shënon, por bëhet treguese dhe e tiparit mbi të cilin ngrihet emërtimi (tashmë një fjalë e vetme). Po e ilustruam këtu me emërtimet e pathjeshta dhe me fjalët e mëvetësishme që lidhen me leksemën **lopë**.

*Lopë beronjë, shif: beronjë.*

*Lopë kuqlë, shif: kuqlë.*

*Lopë larike, shif: larike.*

*Lopë sysklë, shif: sysklë.*

*Lopë sheglë, shif: sheglë.*

*Lopë zesklë, shif: zesklë etj.*

## KREU VI

### VLERA LEKSIKOGRAFIKE TË “FJALORHIT TË RI”

#### A. STRUKTURAT KUPTIMORE DHE SHPJEGIMET E KUPTIMEVE

Prof. Jani Thomai, në kreun për Semasiologjinë leksikore të gjuhës shqipe, pranon se në Fjalorët e shqipes kemi 4 lloje shpjegimesh të kuptimeve leksikore: shpjegimi me perifrazim, shpjegimi me përshkrim, shpjegimi me përkufizim dhe shpjegimi me sinonimi<sup>38</sup>.

Edhe pa qenë leksikograf, Pano Tase, me intuitë gjuhësore ka dhënë në Fjalorsh shumë shpjegime që mund të përfaqësojnë gjitha llojet e shpjegimeve të mësipërme. Megjithatë ne duhet të parashtrojmë se në Fjalor gjejmë

a. Shpjegime kuptimore të sakta, të ndërtuara drejt që na lidhin saktësisht me realitetet e botës materiale a shpirtërore.

b. Shpjegime që jo gjithnjë janë të sakta ose të paplota. Këtu edhe mund të supozojmë se nganjëherë autori në mënyrë të ndërgjegjshme mund të të mos i ketë dhënë semat që na çojnë të objekti.

#### 1. Shpjegime me perifrazim

Shumë shpjegime kuptimesh bëhen me një perifrazim të shkurtër. Por më tutje gjejmë shumë ndërtime si frazeologji, si fjalë të urta ose pjesërisht si frazeologji. P.sh., në Fjalor gjejmë fjalën **darkë**. Meqenëse kjo fjalë është shumë e njohur, autori jep një thënie me vlerë frazeologjike dhe nuk shpjegon fjalën titull, por frazeologjinë: **darkë**: *Sh.: mbeti pa një darkë bukë – mbeti trokë në djell; mbeti keq tek e keqeja; mbeti pa një ovullë, pa një dorë mjell, fifullë; ubë për të këputur shpirtin; u bë kripë (ubë krip?) derri; u bë rrip daulle (fj. e huaj).*

Pavarësisht nga të metat leksikografike (për fat të keq, të përmenduar kaq shpesh edhe nga ne), në Fjalorshin e ri gjejmë edhe shpjegime që janë të

---

<sup>38</sup> J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 1999, f. 133-137

sakta. P.sh. për fjalën **grashinë** kemi një shpjegim që fillon me klasën a llojin ku bën bjesë kjo bimë (barishdë / barishte) dhe mandej vazhdohet me sea të tjera: **Grashinë** (-na): *barizhdë e egër që rritet ndëpër ara në dëm të të mbjellavet, bën një kokrë si urofi.*

## 2. Shpjegimi me sinonim

Në përgjithësi me sinonimi shpjegohen fjalë që i lidhen me nocione abstrakte. Por nuk mungojnë edhe për nocione konkrete. Do të sillnim më poshtë dy - tri raste për ilustrim:

**Koritur (i -):** i kuritur; i uritur; i urëtuar për së tepërmi; i marrë, i zënë urija sytë.

**Vuratë (-ta):** vurratë,; vrajtë; brajë; mbresë.

Tërheq vëmendjen se P. Tase shumë shpesh, veçanërisht kur shpjegon emërtimet e pathjeshta përdor, aty ku e ka gjetur, barasvlerësin fjalë të vetme, duke ndihmuar edhe në pasurimin e gjuhës me emërtime njëfjalëshe, por edhe duke përudhësuar të tjerët për fjalorët terminologjikë që i mungonin shqipës së asaj kohe. P.sh. **dhi balë**, shif: *balë*; **dhi barxhë**, shif: *barxhë*; **dhi breskë**, shif: *breskë*; **dhi çaponjë**, shif: *çaponjë*; **dele çullë**, shif: *çullë*; **dele llajkë**, shif: *llajkë*; **dele kaleshe**, shif: *syskë*; *kaleshe*; **dele llajë**, shif: *llajë*; **dele syskë**, shif: *syskë*; **dele vakërë**, shif: *vakërë*.

Ashtu si edhe te Fjalori shqip - greqisht i Kostandin Kristoforidhit<sup>39</sup> a në fjalor të tjerë si ai i N. Gazullit, gjejmë edhe ndonjë formulë shpjegimi, si **një si** që është e barasvlershme me shpjegimin me sinonimi. P.sh. **Qafëzi** (-ziu; fem.: qafëzezë): një si : qafëthyer, qafëkëputur.

## 3. Shpjegimi i përzier

Tërheq shpesh vëmendjen në fjalor mënyra e përzier e shpjegimit, duke perifrastuar e duke përshkruar dhe duke përdorur sinonime. Këto gati janë të përhershme, herë prijnë shpjegimin e herë e mbyllin atë. P.sh.,

---

<sup>39</sup> K. Kristoforidhit, Fjalor shqip – greqisht, Tiranë, 1961

**Zhurrë:** mëllë, plënkë në zemër; pikëllim i madh zemre, shpirti, sidomos kur nuk harrihet një qëllim, o nuk bëhet një dëshirë.

Sh., shkoj zhurrë i shkreti – vdiq me pahirë, vdiq nga e keqja, nga brenga, nga plëngu i zemrës.

Në këtë shpjegim të përzier, autori fillimisht ka dhënë si barasvlerës të fjalës **zhurrë** sinonimet **mëllë** dhe **plënkë** që janë fjalë të mbarë shqipes dhe të njohura për përdoruesin e fjalorit. Por ai në mënyrë intuitive e kupton se shpjegimi është i paplotë ndaj fillon dhe perifrazon më hollësisht me sinonimin **pikëllim** që e zbërthen imtësisht.

Këto lloj shpjegimesh janë më të pranishmet në vepër.

Te fjala **vesh-shpuar** shpjegimi fillon si sinonimik, vazhdon si perifrazues e mbaron si sinonimik. Si një meritë të jashtëzakonshme në shpjegimet e kuptimeve të fjalëve do merrnim praninë e shumtë të sinonimeve brenda strukturës kuptimore. **Vesh-shpuar** është shumë domethënëse:

**Vesh-shpuar (-ri):** i pjekur; i regjur; i rrëgjur; i kupëtuar; i mësuar; i hollë; i parë në jetë; që ka, që di shumë nga jeta; i mënçur.

Ka shumë raste kur P. Tase **kalon edhe në struktura kuptimore enciklopedike**, duke na dhënë edhe elemente që nuk i takojnë semantikës leksikore a fjalorëve shpjegues, por fjalorëve enciklopedikë:

**Verojkë (-jka):** vereore; dredhëzë 3-4 fijesh leshi me ngjyra të ndryshme që, sidomos çupat dhe nuset të ra, lidhin në rrëzë të dorës së djathtë ditën e Verës së parë (1 Mars) si rruazë për etet a për të pasur shendetin të pacënurr gjatë vitit, diku edhe për të mos të pasur brenga në fytyrë nga zhegu i djellit gjatë Verës së amdhe. Verojkat i mbajnë rreth dorës gjer mbë të ardhurit të dellëndyshevet dhe atëhere i mvarin nga dega pemësh që t'i marrin këto për të ngrehur folenë o për t'i hedhur në det si ç'e besojnë ngjetiu.

Nuk janë të rralla rastet **kur nuk gjejmë emërtime si fjalë titull**, por ato mund t'i hasim rregullisht si përbërëse të strukturave shpjeguese. P.sh.,

**Faqerroshtë** jepet në fjalor si semë shpjeguese, por nuk del si fjalë titull. Si fjalë titull nuk del as gjymtyra **rroshtë**.

**Gjumëmath** e gjejmë si sinonimi shpjeguese (mbyll vargun e shpjegimit perifrases), por vetë kjo kompozitë nuk pasqyrohet në Fjalorth. (duhet të themi se kjo fjalë përdoret edhe si kompozitë dëshirore: *bëfsh gjumin e madh, o gjumëmadh!* = vdeksh!)

## B. RRETH ÇERDHEVE PARADIGMATIKE FJALËFORMUESE NË FJALORTH

*Fjalorthi i ri* i Pano Tases shfaq mangësi edhe në një këndvështrim tjetër leksikografik. Duke mos qenë specialist, autori shpesh nuk i ka mbledhur veçanërisht fjalët në çerdhen e tyre fjalëformuese, si segmente të vargjeve fjalëformuese. Nuk po flasim këtu për fjalë të leksikut të përgjithshëm a të mbarë shqipes, por për emërtime që ai i sheh si njësi që gjenden vetëm në krahinën nga vjen. P.sh., ne gjejmë shumë mbiemra prejpjesorë që nuk jepen me foljen gjegjëse nga janë formuar, apo pranë emrave të veprimit etj. (që nuk i gjejmë në vepër). Le të përmendim këtu **fragjuar** (i -); i terur nga ujërat e shiut (për tokën, për arat). Sh.: tokë e fragjuar – tokë e terur, tokë e tharë në mënyrë që të mund të punohet për t’u mbjellur.

Megjithatë çerdhet paradigmatiske fjalëformuese nuk mungojnë<sup>40</sup>.

*Ardhje – ardhjemath – ardhjeshtyrë; bisht – bishtezë – bishtje – bishtuk; buzë – buzël – buzëpaqeshur – puzëplasur; gojë – gojak – gojëzë – gojëbilbil – gojëmbërthyer; sy – sysk – sysklë – sysplasur – syçakërr etj.*

---

<sup>40</sup> H. Pasho, Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri” të Pano Tases, SF, 3-4, 2001, f. 126-127



## C. THËNIET DHE VENDI I TYRE NË FJALORTH

Në pjesën më të madhe të fjalëve dhe të njësive frazeologjike që janë pasqyruar në *Fjalorthin e ri* (1941) nuk mungojnë edhe thëniat, shpesh të marra drejtpërdrejt nga goja e përmetarit, por edhe të krijuara nga vetë P. Tase.

Në vartësi nga gjendja e fjalës dhe nga përkatësia e saj (si fjalë dialektore a si fjalë e mbarë shqipes) P. Tase jep dy lloj thëniesh:

1. Nëse fjala është e njohur për përdoruesin, shpesh jepet fjala titull pa shpjegim, por jepen patjetër shembuj në thenie të lira ose në përdorime frazeologjike, duke i shpjeguar hollësisht si:

*Dal:Sh., s'i dilet me të ligun – s'ka ç'bën i miri, i urti kur i ka rënë mbë qafë, kur e mundon, kur e tmerron ndonjë njeri i lik; është keq kur ndez njeriu me një të lik.*

Kemi theksuar disa herë se një nga pasuritë më të mëdha të Fjalorthit është frazeologjia dhe shprehjet popullore. Hartuesi i veprës vjen ***me një ndihmesë të paçmuar edhe në shjegimet e kuptimeve a të thënieve me anën e këtyre njësive.*** Ja konkretisht:

*darkë: Sh.: mbeti pa një darkë bukë – mbeti trokë në djell; mbeti keq tek e keqeja; mbeti pa një ovullë, mbeti pa një dorë miell, ffullë; ubë për të këputur shpirtin; ubë kripë (ubë krip?) derri; u bë rrip daulle (fj. e huaj).*

2. Kur fjala është dialektore, jepen shpjegimi por nuk mungojnë edhe thëniat, si mikromjedise komunikimi:

*breskë (-ka): fjalë për kafshë; me bres që ka bres në bark; që ka një rrip, një fashë të bardhë ndënë bark, tek qimen e trupit e ka ngjyrë të ndryshme, të zezë o të murrme; rripi fasha nis nga brinjët dhe mbaron në bark.*

*Sh. dhi breskë – dhi e zezë që ka një rrip të bardhë në bark.*

## KREU VII

### MARRËDHËNIET E PASURISË LEKSIKORE, SEMANTIKE E FRAZELOGJIKE TË “FJALORHIT TË RI” ME LEKSIKUN E GJUHËS STANDARDE

*Fjalorthi i ri* u botua në vitin 1941. Është e kuptueshme që ai është shfrytëzuar patjetër sidomos fjalësi dhe pasuria shumë e madhe frazeologjike që përmban, në hartimin e të parit fjalor shpjegues të mirëfilltë të shqipes që pa dritën e botimit 13 vjet më pas<sup>41</sup>. Ne nuk do të ndalemi shumë në ballafaqimin e këtyre dy fjalorëve. E shohim të kapërcyer, por edhe të kushtëzuar nga përmasat e punimit. Jo një herë kemi thënë se *Fjalorthi* është anashkaluar për rreth 50 vjet ose është parë si fjalor me lëndë të ngushtë krahinore.

Por trajtimet shkencore të viteve të fundit kanë nxjerrë në dritë të kundërtën. Ai ka një pasuri që është shfrytëzuar në të parin fjalor të shqipes standarde<sup>42</sup> dhe duke e riparë edhe njëherë gjithë lëndën që ai sjell mund të themi se *Fjalorthi i ri* nuk duhet vlerësuar thjesht si një hallkë e vyer e traditës sonë apo një trashëgimi shumë e çmuar etnokulturore. Ai duhet të pranohet edhe si një burim real me të cilin shqipja letrare e ditëve të sotme mund ta rrisë fuqinë e saj potenciale.

Para së gjithash duhet të ritheksojmë një fakt që shpesh lihet në harresë. Në vitin 1955 u krijua Kartoteka e Leksikut të Shqipes. Në ***këtë kartotekë gjendet i skeduar i gjithë fjalësi i Fjalorthit të ri***, ndaj shumë njësi leksikore, semantike, frazeologjike apo edhe thënie si ilustrim mund të jenë nxjerrë nga ky fjalor dhe janë në procesin e hartimit të fjalorëve të ndryshëm shpjegues, duke fituar kështu karakteristikën e të qenit “anonime”.

---

<sup>41</sup> Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954

<sup>42</sup> Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980

## A. FJALORËT SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPES DHE “FJALORTHË I RI”

*Fjalorthi i ri* i Pano Tases, botimi im vitit 1941, si vëllim XII i serisë “Visaret e Kombit” ka rreth 214 faqe dhe ka më shumë se 2000 njësi<sup>43</sup>. Materiali gjuhësor është grumbulluar në trevat e Përmetit dhe përreth tyre a u përket të folmeve të Jugut të Shqipërisë. Hënë Pasho vëren se pasuria leksikore, semantike e frazeologjike “pasqyron një gjendje të të folmeve që është karakteristike për kohën kur është mbledhur, pasqyron, gjithashtu, edhe një shkallë të caktuar në procesin e njohjes, gjë që ka kushtëzuar edhe interpretimin leksikografik të materialit gjuhësor. Natyrisht, edhe në këtë fjalor, ashtu si edhe në fjalorë të gjuhës së përgjithshme letrare, nuk mund të jetë pasqyruar sistemi leksikor, qoftë edhe i këtyre të folmeve, në gjithë vëllimin e tij. në mangësitë ose në pasaktësitë që mund të vihen re kanë ndikuar një varg faktorësh e vështirësi të e karakterit subjektiv”<sup>44</sup>.

Pano Tase ishte një nga ata atdhetarë e lëvrues të gjuhës shqipe që punuan me zell e me dashuri të përkushtuar për fjalën shqipe, që mbledhën e botuan në fjalorthë ose në shtypin e kohës shumë fjalë e shprehje të bukura popullore. Por ai ishte një nga ata dijetarë që siç thotë J. Thomai, ishin të paformuar gjuhësisht, kështu që në studimet e tyre ka edhe “dilentatizëm, kritere e parime të marra andej-këndej e nganjëherë të kundërta”<sup>45</sup>. Pano Tase ndryshe nga autorët e tjerë të fjalorëve (N. Gazulli, K. Kristoforidhi etj.) nuk kishte formim gjuhësor, madje nuk ishte as studiues i mirëfilltë. Ai ishte në emigrim dhe vërente me shqetësim se shumë bashkëkombas të tij nuk e përdornin shqipen as në mjediset familjare. U ndje i frikësuar se kjo mund të ndodhte me shqipen edhe në Shqipëri, sidomos kur kjo ishte nën kërcënimin e

---

<sup>43</sup> Hëna Pasho pranon 2000 fjalë, ndërsa Ledi Shamku pranon 1600 të tilla.

<sup>44</sup> H. Pasho, *Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri”* të Pano Tases, SF, 3-4, 2001, f. 122

<sup>45</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 11

italishtes dhe të gjuhëve të tjera evropiane shumë të përpunuara. Kur u kthye në vendlindje, “iu vu punës për mbledhjen e fjalëve në Jug të Shqipërisë me këmbëngulje, me përkushtim, me gjithë vështirësitë e natyrshme, por gjithnjë e më tepër i tërhequr dhe i entuziazmuar nga pasuria e fjalëve që mblidhte, me vetëdijen që bënte një punë të vlefshme për gjuhën, një punë që do të ndihmonte shqiptarët ta njihnin më mirë këtë pasuri të gjuhës”<sup>46</sup>.

Nga shumë studiues, si jemi shprehur në kreun e mëparshëm, fjalorët si ai i Tases etj., sidomos ata të botuar para fjalorit të parë shpjegues të shqipes, (Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954) trajtohen si fjalorë me bazë të ngushtë dialektore<sup>47</sup>.

Ka një të vërtetë brenda këtyre pohimeve, ashtu siç ka edhe një kontradiktë. Nëse ne e studiojmë dhe e interpretojmë lëndën që ata pasqyrojnë nga koha e sotme, shumë fjalë të tyre janë përfshirë në leksikun e përgjithshëm të shqipes standarde. Nëse e studiojmë thjesht se në cilën hapësirë gjuhësore – gjeografike është mbledhur, atëherë mund ta vështrojmë si lëndë gjuhësore me përdorim të ngushtë krahinor.

Lënda leksikore (fjalë), lënda semantike (kuptime a nuanca kuptimore) si dhe frazeologjia dhe shprehjet popullore në faqet e Fjalorthit të ri mund të grupohet në dy grupe të mëdha:

a. ***Leksiku i mbarë shqipes*** që gjendet edhe në FGJSSH (1980).

Studiuesja H. Pasho është marrë gjerësisht me vendin që zë lënda gjuhësore e *Fjalorthit të ri* në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, duke parashtruar se “fjalorët janë të tipit të ndryshëm, hartuar në kohë të ndryshme

---

<sup>46</sup> H. Pasho, *Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri”* të Pano Tases, SF, 3-4, 2001, f. 122

<sup>47</sup> Shih për këtë edhe A. Kostallari, Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, në *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe*, 2, Tiranë, 1972, f. 3-80

dhe si, rrjedhim, pasqyrojnë edhe shkallë të ndryshme të zhvillimit të gjuhës”<sup>48</sup>  
Kjo studiuese duhet të theksonte patjetër (edhe pse kjo nënkuptohet) se krahasimi duhet të kishte në bazë edhe hartuesin / hartuesit e secilit fjalor, traditën leksikografike njëgjuhëshe të shqipes, mosekzistencën / ekzistencën e Kartotekës së leksikut të shqipes, punën e planifikuar dhe të organizuar / ose jo të tillë etj. që përcaktojnë edhe ndryshimin ndërmjet këtyre dy fjalorëve.

1. Pjesa më e madhe e fjalëve të *Fjalorthit të ri* është përfshirë në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, çka tregon për vërtetësinë edhe saktësinë e punës së autorit për mbledhjen e materialit gjuhësor si leksik. H. Pasho thekson se nga 1000 fjalë-titull të analizuar (emra, mbiemra, folje) vetëm 120 prej tyre nuk janë në Fjalorin e 1980<sup>49</sup>.

2. Ashtu si për leksikun, edhe për frazeologjinë mund të thuhet se në Fjalorin e 1980-s është pasqyruar pjesa më e madhe e asaj që gjendet në *Fjalorthin e ri*.

3. Kuptimet e shumë fjalëve të Fjalorthit të Pano Tases shfaqen në Fjalorin e 1980-s si kuptime të para të fjalëve (*buburizë, çepellë, ngjëronj, shtalpë, i shugatur, dhëmbarash* etj.) ose si kuptime dytësore (shih kuptimet e fjalëve *brçe, spurdhjakës, shpirre, floke, dimërore, i legendisur, i mektë, i zhezhitur* etj.)<sup>50</sup>.

b. *Leksiku dialektoro – krahinor*, që i takon një areali të ngushtë përdorimi gjuhësor.

Por duhet të pranojmë se pjesa më e madhe e këtij leksiku, për të mos thënë gati e gjitha i përket tashmë gjuhës letrare kombëtare, gjë që do të thotë

---

<sup>48</sup> H. Pasho, *Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri”* të Pano Tases, SF, 3-4, 2001, f. 127

<sup>49</sup> H. Pasho, *Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri”* të Pano Tases, SF, 3-4, 2001, f. 127

<sup>50</sup> H. Pasho, *Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri”* të Pano Tases, SF, 3-4, 2001, f. 122

se edhe pse nuk mund të jetë pasqyruar në Fjalorin e 1980 a në fjalorët e tjerë të shqipes<sup>51</sup>. Në fjalorin e madh të ardhshëm të shqipes ato duhet të zënë vend patjetër.

Ne po japim më poshtë një grup fjalësh të tilla, që i takojnë të folmes së Përmetit të viteve '30 – '40 të shekullit XX.

**Beçka (beçkat):** breçka, brekë; të mbathura.

**Bicok (-ku):** derr i vogël i majëm; zok derri i majëm; derrkuc.

**Bilok (-gu):** stavë; turrë; tok; grumbull. Sh.: ubë bilogu i math – një tok i math; umbëlodh (umbëlodhën) bilok.

**Byrdë (-da):** leshje, burdhë për të mbuluar vithet' të kalit.

**Cerimangë (-ga)** pëlhurë, cergë marimange.

**Çepeke (-ja)** baluke; flokë të gjatëqë lënë mbi ballë; tufë flokësh që e lënë mbi tutul të ballit mbë të qethur.

**Çip (-pi).** Sh.: çip më çip – an'mb'anë; mbë gjithë anët. E punon arën çip më çip – nuk lënë asnjë pëllëmbë pa punar; ia punon gjithë anët e cepat.

**Çkëth:** dhjes. Sh.: e çkëthi – e lidhosi; e dhjeu.

**Çkëthem:** dhjes, dhitem. Sh.: uçkëth – dhjeu, udhje.

**Çkëthëtore (-ja)** ligë; e dalme shtëpije; der'e vogël shtëpije.

**Dockë (-ka; dockat):** kalli; koçumbe, korcallë; misërishte, kallamishte misëri pas si të shkoqen kokërrat. Doçkat të grira hyjnë në punë për ushqim të lopëve në dimër, po përdoren edhe për të djegur në vatër, dhe si mbulesa për qelqe, për shtëmba, për bucela etj. sh.: i vuri dockën, shif: dërrmë (i dha –).

**Lidhos:** Sh.: e lidhosi, shif: copë (ja bëri samarin copë). Sh., e lidhosi, shif: çkëth.

**Lovidhë (-dha):** bishtajë; mashurkë. (shënim: thuhet sidomos për bishtajat të njoma të fsule, të bathës etj.).

---

<sup>51</sup> Shih për këtë Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980; Fjalorin e shqipes së sotme, Tiranë, 1984 / 2002; Fjalorin sinonimik të gjuhës shqipe, Tiranë, 2004; Fjalorin Frazeologjik të gjuhës shqipe të J. Thomait, Tiranë, 1999 etj.

**Llozhar:** njeri i lloshave, i lëmishtave, i plehërave, njeri i ndragur me plehurina, me lëmishta. § njeriu i ngarkuar me të mbëledhurit të plehut dhe të fshiravet të rrugëve.

**Feshe:** pandufle, heqëla për brenda shtëpisë.

**Fice:** Sh.: gorricë fice – gorricë e bërë, e pjekur e harrirë tepër, gorricë e rreshkur.

**Fuçkë:** fulltak; flluckë; plluckë prej të djeguri, prej të përvëluari.

**Gazhel (-li):** gomar; kërr, kapuq.

**Kopaçis:** thyenj, dërrmonj plisa (buza) me shatën nd' arë.

**Sgardhallomë (-ma):** shkatërrinë, gjë e shkatërruar. Sh.: një sgardhallomë shtëpije – një shtëpi e shkatërruar; një shkreto-shtëpi.

**Sgjunzë (-za):** xgjunzë, zgjonzë, sgonjë; puqrë që del majë gishtrinjëvet, rreth thonjëvet dhe sjell të dhëmbura të forta; shpeshherë kjo puqrë mahitet e egërsohet tepër sa që ndjell dhe të rënët e thojt. Gjindja beson se sgjonja vjen nga qumështi i fiqëvet, kur uqërojnë cipën me thonj.

**Vulomë (-ma):** mbulesë prej druri, prej korcallje etj., për të zënë grykën e bucelave.

**Zhokrë (-ra):** lëmishtëra, gjethe, drurë, baltë, gurë që rrëzojnë përrenjtë, kur shtojnë zbresin me rrëmbim.

**Zhumbëlë (-la):** poplë, poprë guri; gur i math.

Edhe në grupin e njërive që mund ta shohim si krahinor-dialektor, mund të bëjmë disa dallime.

1. Ka në Fjalorth një grup fjalësh që nuk janë në Fjalorthin e 1980-s, sepse nuk kanë trajta të njëjta fonetike a morfemore (krahaso: *kazel / kazil, ngjirith / njerith, blegëronj / blegërin, i puthosur / i puthitur, buzëvartur / buzëvarur, syplasmë / syplasur etj.*)<sup>52</sup>.

---

<sup>52</sup> H. Pasho, *Vështrim mbi leksikon krahinor të "Fjalorthit të ri"* të Pano Tases, SF, 3-4, 2001, f. 127-128

2. Ka fjalë të Fjalorthit që në Fjalorin e 1980-s kanë kuptim tjetër, pra nuk është pranuar si normativ kuptimi që është regjistruar nga P. Tase, por një tjetër (*kuçumare – pema e mares si luleshtrydhe e madhe / koçimare – mare etj.*)<sup>53</sup>

3. Ka edhe njësi frazeologjike që nuk janë pasqyruar në Fjalorin e 1980-s, si *ri më dhëmballë, më nxori gërnjaksin, iu pre koka, më krisi kurrizi, më ra ngjirithi së thirruri, s'jep as të zit e thorit* etj.

4. Edhe pse i takojnë kulturës popullore, shumë shprehje popullore mund të zinin vend në Fjalorin e 1980-s si thënie, si ilustrime të kuptimeve me të cilat dalin fjalët në përdorim.

Fjalësi i Fjalorthit të ri është grumbulluar në Jug, por ***aty gjejmë edhe njësi që i përkasin gegërishtes:***

a. Disa njësi emërtuese, sidomos disa emërtime të thjeshta kanë në përbërjen e tyre fjalë që janë të trajtave të gegërishtes. Nuk e dimë se si kanë ardhur në faqet e Fjalorthit, të regjistruar prej ndonjë folësi gegë që punonte në Përmet a të dëgjuara nga Pano Tase në mjediset në mërgim. Kështu, do të sjellim për të ilustruar emërtime si **bukë e huptë / bukë e uptë** (bukë e vjetër, e motuar); **bukë e mbryme** (bukë e zënë me brumë, me farë), **i ve brengë kresë kot; ndrag, zok derri, gem**, drojë etj.

b. Aty-këtu ndeshim gjithashtu edhe forma të shumësive që janë veçori dalluese e të folmeve veriore. P.sh., hu (-ri) nuk e bën shumësin me **-nj (hunj)**, por me **-j (hujt)** (purteka (dega) të gjata dhe të holla që përdoren për të lidhur pemë të vogëla a hardhija pas hujvet); *bari i mijve* (për *bari i minjve*),

---

<sup>53</sup> H. Pasho, *Vështrim mbi leksikon krahinor të "Fjalorthit të ri"* të Pano Tases, SF, 3-4, 2001, f. 127



## B. FJALORI I MADH I SHQIPES DHE “FJALORTHI I RI”

Shqipja e ka tashmë domosdoshmëri hartimin e një fjalori thesar<sup>54</sup>. Ajo ka në përdorim katër fjalorë shpjegues, me dhjetëra fjalorë dialektorë e krahinorë, rreth 40 fjalorë terminologjikë dhe me dhjetëra e me dhjetëra artikuj studimorë dialektologjikë që shoqërohen me nga një fjalorth etj.

Prof. Shezai Rrokaj i mëshon faktit se “vetë larmia demografike e politike ku gjenden shqiptarët bën të domosdoshme ruajtjen dhe pasurimin e standardit nëpërmjet përfshirjes gjithmonë e më të madhe të njësive dhe të strukturave të mbarë gjuhës sonë dhe të përdorimit të varianteve, të cilat i japin hijeshi mozaikut gjuhësor dhe tregojnë pasurinë dhe vitalitetin e tij”<sup>55</sup>.

---

<sup>54</sup> Sh. Rrokaj, *Hartimi i fjalorëve dhe i gramatikave thesarë, një mundësi më shumë për pasurimin e gjuhës standarde shqipe*, në “Konferenca shkencore Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003, f. 274

<sup>55</sup> Sh. Rrokaj, *Hartimi i fjalorëve dhe i gramatikave thesarë, një mundësi më shumë për pasurimin e gjuhës standarde shqipe*, në “Konferenca shkencore Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003, f. 274

## KREU VIII

### VEÇORI FONETIKE E MORFOLOGJIKE DIALEKTORE TË LESIKUT TË “FJALORTHIT TË RI”

*Fjalorthi i ri* i Pano Tase nuk mbart vetëm vlera të rëndësishme leksikore, semantike, frazeologjike apo leksikografike. Ai është njëkohësisht regjistruar dhe pasqyruar i veçorive dialektore fonetike e morfologjike që karakterizojnë të folmet e Jugut dhe sidomos të Folmen e Përmetit nga mesi e deri nga fundi i viteve '30 të shekullit XX. Ndaj ai mund të shfrytëzohet me sukses edhe për studime të kësaj fushe. Ne po përmendim vetëm disa nga këto karakteristika.

Shembuj mund të jenë fjalë në trajtën përfaqësuese, por së shumti mund të jenë elemente të paradigmave të eptimit të këtyre fjalëve, sidomos kur jepen veçori të kategorive gramatikore dhe të mjeteve të shprehjeve të tyre.

#### A. DUKURI DIALEKTORE KRAHINORE FONETIKE

1. a. Siç dihet, një nga dallimet ndërmjet toskërishtes dhe gegërishtes është se në toskërishte ndodh(te) shumë shpesh **shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës**. Në Fjalorth këtë dukuri e ndeshim gati kudo.

*Avlëmënt (-ndi), (është) lark, pellk, ardhjemath, alurimë (ulërimë); ap (ap e marr), i bëfëshmë (i bëshëm), bjenj (rashë); zok, shpent, erdhi (hardhi), bilok (-gu), tok (-gu) një tok i math; vënt (vend), elp (elb), i çjerrur (i çjerrë), gërpjepat (greqat) etj.*

b. Në Fjalorthin e ri gjemë të pasqyruar edhe një dukuri tjetër të të folmeve jugore, shurdhimin e shpeshtë të bashkëtingëlloreve, jo vetëm në fund por edhe në ballë të fjalëve. Kështu **s- / sh- / x-** para bashkëtingëlloreve të shurdhëta shpesh shfaqen përkatësisht si **c- / ç- / z-**. P.sh., *ckërfyell* (për *skërfyell*), *cmilar* (për *smilar*); *çqep* (për *shqep*), *xgjunjë* (për *zgjunjë*),

c. **Shurdhimi** mund të shfaqet edhe në trup të fjalës. P.sh., *i mërxitur* (për *i mërzitur*),

2. Nganjëherë para bashkëtingëlloreve të zëshme mund të gjendet një bashkëtingëllore e shurdhët (mund të jetë dhe parashtesë fjalëformuese), dukuri kjo e njohur në toskërishte. P.sh., *sbukuroj* (për *zbukuroj*), *Sgardhallomë (-ma)*:

3. Fjalori gati e ka në sistem përdorimin e **ë-së** në vend të **e-së** së theksuar para bashkëtingëlloreve hundore **m, n, nj**. Do të sillnim për ilustrim njësi të tilla, si *trëmbem, brënda, parmëndë* etj.

4. Në Fjalorthin e ri të Pano Tases mund të gjejmë edhe **zëshmimin** e bashkëtingëlloreve si akomodim (bashkëtingëllore e zëshme + bashkëtingëllore e shurdhët bëhen të dyja të zëshme). P.sh., *i mbrehur* (për *i mprehur*),

5. Një veçori tjetër e te folmeve jugore (brenda tyre edhe ajo e Përmetit) është dukuria e **protezës**, e shtimit të një tingulli parazitar në ballë të fjalës. Kjo duket sidomos të fjalët që fillojnë me zanore. P.sh.: *i harrirë* (për *i arrirë*), *hiku* (për *iku*), *mos harrifsh* për *mos arrifsh*)

Në Fjalorth gjejmë edhe shtimin e një tingulli bashkëtingëllor, sidomos kur këta janë homoorganik, por edhe një tingull tjetër duke u akomoduar (duke u shurdhuar a duke u zëshmuar si ndryshim kombinator). P.sh., *i mblermë* (për *i blermë*); *mbletë* (për *bletë*); *mbrymë* (për *brymë / brumë*); *mvarin* (për *var*), *ngjetiu* (për *gjetiu*) etj.

6. Në Fjalorth gjejmë gjithashtu shumë raste të dukurisë së **epentezës**, të shtimit të një tingulli parazitar në trup të fjalës. Këtu dallojmë dy grupe paradigmatiske:

a. shtimin e një tingulli zanore, zakonisht të **ë-së** që më të shumtën e rasteve shfaqet si zanore paratheksore. P.sh., *umbëlodhën* (u *mbloodhën*), *vëjen* (*vlen*),

b. shtimin e një tingulli bashkëtingëllore: *buzëvartur* (për *buzëvarur*), *mbë* (për *më*),

Tingull shtues mund të jetë edhe një bashkëtingëllore që ka vlerë antihiatizuese, si *sgardhallomë shtëpije* për *sgardhallomë shtëpie*).

Tek - tuk mund të gjejmë shtimin e një rrokjeje, që më saktë nënkupton shtimin e një bashkëtingëlloreje dhe të një **ë**-je mbështetëse, si *i bëfëshmë* (për *i bëshëm*),

7. Një nga veçoritë dialektore të spikatura të krahinës së Përmetit është dhe dukuria e *metatezës*, sidomos e zonës së Ballabanit dhe të Bubësit. Jo rrallë gjemë fjalë që jepërn me ndërrim rrokjesh a fonemash. P.sh., *qlofkë* (për *qofklë*), *të tfillurit* (për *të ffillurit*) etj.

## B. DUKURI DIALEKTORE KRAHINORE MORFOLOGJIKE

Dukuri tjetër morfologjike në Fjalorth, që del si tipar krahinor, mbase edhe (konservativ), është që mbaresat e vetës së tretë shumës, të të kryerës së thjeshtë, për foljet e zgjedhimit të dytë nuk dalin me formën **-ën**, por **-në**, pra **ë-ja** nuk del si tingull (fonemë) mbështetëse, por si tingull fundor. P.sh., *e çokitnë* (për *e çukitën*), *e quknë* (për *e quknë*).

Në të folmet e Jugut, brenda tyre edhe në të folmen Përmetit, foljet e zgjedhimit të parë, në kohën e tashme të mënyrës dëftore (por edhe në të tashmen e lidhores), veta e parë, numri njëjës, në Fjalorth e gjejmë jo me mbaresën **-j**, por me mbaresën **-nj**. P.sh., *alurinj* (*ulërinj*), *gumëzhinj*, *oshëtinj*, *buçinj*, *gjëmonj*, *kumbonj*, *bënj qërtonj*, *të ndreqnjë* (*të ndreq*), *braninj* (*branis*), *çanj* (*çanj ferrën*) etj.

Megjithëse nuk shfaqet si veçori dialektore duhet të pranojmë se hartuesi i Fjalorthit, jo rrallë nuk ndërton saktë format e shumësit. Kjo bie në sy tek emërtimet e pathjeshta, si te **bar**: Sh.: bar lëkure (shum: *bar lëkurash*) Sh.: bar mole (shum: *bar molash*). Në vend që të pranohet si emërtim i pathjeshtë që nuk ka formë të shumësit, në fjalor jepet shumësi i gjymtyrës së dytë të emërtimit, si shumës i gjithë njësisë emërtuese.

Të folmet e Jugut e kanë gati të gjallë rasën vendore me **-t(ë)** fundore. Edhe nëse fjala nuk shënon vend, por përdoret me vlerën e rrethanorit të vendit, kjo formë nuk mungon. Në fjalor gjejmë përdorime të shpeshta të kësaj rase. P.sh. ... *në shqipet* (për *në shqipe*), *në barkut* (për *në bark*).

## PËRFUNDIME

1. Në këtë punim mikroteze u ndalëm në lëndën që përmban *Fjalorthi i ri* i Pano Tases, i botuar në vitin 1941, duke e vlerësuar si një nga të parët fjalorë jo thjesht krahinor, me një pasuri të madhe leksiko-semantike, frazeologjike dhe shprehjesh popullore të rrethit të Përmetit, por edhe për ndihmesën e tij të drejtpërdrejt në *përudhësimin e leksikografisë shqipe njëgjuhëshe*.

2. Fjalorthi i ri mbart disa mangësi që kanë kushtëzimet e kohës, të traditës leksikografike e leksikologjike dhe së fundi të mungesës së profesionalizmit të hartuesit. Por ai shpërfaq lëndë të vlerësueshme leksikologjike, dialektologjike, etnolinguistike, sociolinguistike, historike etj., që u përpoqëm t'i paraqesim nën një këndvështrim bashkëkohor dhe pëqër së shumti me konceptin e sistemit në të gjitha rrafshet e analizave.

3. Fjalori ka një lëndë të kënaqshme leksikore, me mbi 1000 fjalë, të cilat janë të leksikut të përgjithshëm, por edhe leksikut terminologjik. Kemi bërë klasifikime taksonimike të hollësishme, përmes konceptit të fushave leksikore, semantike etj. dhe i kemi mëshuar faktit që gati e gjithë lënda e këtij fjalori është skeduar, është bërë pronë gjuhësore e Kartotekës së Leksikut të Shqipërisë dhe është pasqyruar në Fjalorët shpjegues të shqipërisë. Por nëse lënda e ka merituar këtë, Fjalorthi dhe autori për dhjetëra vjet gati kanë qenë anonimë, pa u parë as i si gjendje jo më si vlera.

4. Fjalorthi ka mbi 400 njësi frazeologjike, që janë pasqyruar si fusha leksikore të organizuara te gjymtyra kryesore që i motivon ato, si te *zemër, sy, kokë shpirt* etj. Gjithashtu frazeologjia gjendet shumë edhe në shpjegimet kuptimore të fjalëve, por edhe pranë ndonjë shprehjeje popullore që ka kuptim të figurshëm. Njësitë frazeologjike janë parë sipas vlerave shënuese dhe emocionale, por edhe sipas vlerave semantike, sidomos është parë pasuria e madhe e vargjeve sinonimike që jepen në fjalor. Njësitë frazeologjike ndonjëherë shërben edhe si mjet shpjegues, duke e përmbyllur zakonisht shpjegimin

perifrazues. Nuk është anashkaluar dhe modelimi strukturor dhe ai sipas vlerës leksiko – gramatikore.

5. Një nga pasuritë më të mëdha të fjalorit janë dhe shprehjet popullore që shkojnë rreth numrit 300, ku kemi veçuar mallkimet, urimet, ngushëllimet, betimet dhe përshëndetjet. Ato janë dhënë shpesh si lagje të plota, ashtu si i ka dhënë autori, dhe janë interpretuar semantikisht (jemi ndalur sidomos te kondensimi kuptimor), stukturalisht dhe gramatikisht (jemi ndalur sidomos te modaliteti i foljeve). I kemi mëshuar faktit se ato paraqesin vlera të shumanshme, veçanërisht etnolinguistike, historike, dialektologjike etj.

7. Leksiku është parë: a) sipas morfologjisë së fjalëformimit dhe kemi dalluar emërtime njëfjalëshe, dhe emërtime të pathjeshta. Emërtimet e pathjeshta janë parë si fjalë të parme dhe jo të parme. Këtu kemi parë mënyrat kryesore të fjalëformimit dhe tipet e mjetet e këtij procesi. Shumicën dërrmuese të fjalëve e përbëjnë fjalët e prejardhura dhe kemi dhënë prapashtesat dhe parashtesat kryesore (rreth 30). Interesante janë edhe kompozitat e pasqyruara në fjalor (rreth 70) të cilat dalin këpujore, si ekzocentrike dhe si kompozita dëshirore. Emërtimet e pathjeshta janë me dhjetëra sidomos për emetimet e gjësë së gjallë. P. Tase ka meritën se jep përdorime binare: emërtime të pathjeshta / emërtime njëfjalëshe, si barasvlerës të emërtimeve të pathjeshta.

b. sipas morfologjisë së eptimit dhe kemi dalluar njësi të ndryshmeemra, folje etj. . Me interes ka qenë lagjja e pasthirrmave që lidhen me gjënë e gjallë etj., dhe që janë të shumta në numër (rreth 50).

8. P. Tase nuk ka qenë leksikolog, as leksikograf. Megjthatë na ka lënë një vepër të vyer edhe nga ana leksikografike. Fjalori i tij dhe ai i N. Gazullit përdhësojnë leksikografinë shqipe njëgjuhëshe. Ne kemi gjetur arritje në teknikat e paraqitjes së fjalëve në fjalor, ashtu si kemi gjetur edhe të meta. Në fjalor mbizotërojnë shpjegimet me perifrazim dhe ato me sinonimi. Nuk kemi në asnjë rast makrosisteme (fjalë polisemike), mbase që kemi shumë emërtime terma.

9. Lënda vjen nga areali i Përmetit, fjalori është “krahinor”, ndaj pasuria është parë edhe në marrëdhënie me leksikun e gjuhës standarde. Mund të themi

se gati e gjithë lënda e veprës (me ndryshimet e nevojshme fonetike e gramatikore) sot gjendet e pasqyruar në fjalorët shpjegues a në Fjalorin e fjalëve të urta të popullit shqiptar. Ne kemi dhënë shumë njësi që lehtësisht janë parë si dialektore, për vitet '30 të shekullit të XX.

10. Ishte e domosdoshme që vepra të shihej edhe nga ana dialektologjike, duke parë veçori dialektore fonetike, por edhe morfologjike. Madje aty-këtu kemi parë edhe dukuri a njësi që janë të gegërishtes.

## LITERATURË SHKENCORE

- A. Duraj, Terminologjia si sistem, Tiranë, 2001
- A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe”, 1, Tiranë, 1972
- A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe”, 1, Tiranë, 1972
- A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe”, 2, Tiranë, 1972
- A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe”, 2, Tiranë, 1972
- A. Xhuvani, *Nji Fjalorth i ri*, në Vepra, 2, Tiranë, 1990
- E. Hysa, Formimi i emrave me ndajshtesa, Tiranë, 2005
- F. Bardhi, Fjalor latinisht – shqip, Tiranë, 2006
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980
- Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954 / 2005
- Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984 / 2002
- Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2004
- Fjalë të urta të popullit shqiptar, Tiranë, 1983
- Gj. Shkurtaj, Dialektologjia, Tiranë, 2004
- Gj. Shkurtaj, Etnografi e të folurit të shqipes, Tiranë, 2005
- Gj. Shkurtaj, Kultura e gjuhës, Tiranë, 2006
- Gj. Shkurtaj, Onomastikë dhe etnolinguistikë, Tiranë, 2001
- Gj. Shkurtaj, Emrat e kafshëve sipas ngjyrës, SF, 1, 1971
- Gj. Shkurtaj, Sociolinguistika, Tiranë, 1999
- Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 2002
- Gramatika e gjuhës shqipe, 2, Tiranë, 2002
- H. Pasho, *Marrëdhëniet e leksikut të përgjithshëm me leksikun terminologjik*, në “Konferenca shkencore *Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë, 2003
- H. Pasho, Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri” të Pano Tases, SF, 3-4, 2001



- Hudson, Sociolinguistika, Tiranë, 2002
- J. Thomai, Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 1981
- J. Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, Tiranë, 1999
- J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 1999
- J. Thomai, Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe, Tiranë,
- J. Thomai, Prejardhje semantike në gjuhën shqipe, Tiranë, 1989
- K. Kristoforidhi, Fjalori greqisht – shqip, Tiranë, 1961
- Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë, Tiranë, 2006
- M. Tirta, *Ç'u këput një yll... – këngë dashurie mbledhur nga Pano Tase*, Tiranë, 2001
- N. Gazulli, Fjalori ri (ribotim), Tiranë, 2005
- N. Mërkuri, Kërkime etnolinguistike tek emërtimet e bimësisë, Tiranë 2000
- P. Bogdani, Çetë e Profetëve, Tiranë, 2006
- P. Tase, Fjalorthi i ri, Tiranë, 2006
- R. Ismajli, “Në gjuhë” dhe “për gjuhë”, Pejë, 1998
- R. Ismajli, Tekste të vjetra, Pejë, 2000
- R. Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Tiranë, 2002
- Sh. Rrokaj, *Hartimi i fjalorëve dhe i gramatikave - thesar, një mundësi më shumë për pasurimin e gjuhës standarde shqipe*, në “Konferenca shkencore Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003
- V. Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastrë, 1999
- V. Memisha, Emërtime për kafshë e shpendë në Labëri, Gjirokastrë, 1999
- Xh. Lloshi, Stilistika dhe pragmatika, Tiranë, 1999
- Z. Gjocaj, Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe, Prishtinë, 2001